



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Inxhinieri Softueri”

Universiteti “EPOKA”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Elva LEKA

Dr. Eda TABAKU

Shkurt / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Inxhinieri Softueri"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "EPOKA"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri Softueri"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 220, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2020 – 2021 – 5 / 1 v.a. 2021 – 2022 – 14 / 5 v.a. 2022 – 2023 – 17 / 11
18	Numri i studentëve:	v.a. 2020 – 2021 – 51 v.a. 2021 – 2022 – 101 v.a. 2022 – 2023 – 138
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softueri” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Universiteti EPOKA.

Hapja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softueri” është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 220, Nr. 3582/1 Prot., datë 03.07.2020, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e Inxhinierisë së Softuerit.

Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Inxhinieri Softueri” në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, të Universitetit EPOKA, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Softueri” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2020 – 2021. Në vitin akademik 2020 – 2021, janë regjistruar 51 studentë, në vitin akademik 2021 – 2022, 101 studentë, në vitin akademik 2022 – 2023, 138 studentë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Dr. Elva Leka dhe Dr. Eda Tabaku, me mbështetjen e koordinatorit të ASCAL, MSc. Erion Xhako dhe MSc. Arbri Ndreka.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin Tetor 2023, me dorëzimin nga ana e Universitetit EPOKA të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Universitetin EPOKA, në datat 5 dhe 6 Tetor 2023, GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Përgjegjës të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, të Sektorit të Burimeve Njerëzore, të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.



Më datë 25.01.2024 , përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 44/2 Prot., datë 25.01.2024 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 01.02.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr.131/9 Prot., datë 01.02.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi I.2:**

GVJ: Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara. EPOKA falë bashkëpunimeve me ente vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre. GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, konstaton që Institucioni nuk ka hartuar një raport analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar.

GVB: Marrëveshjet e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike me kompanitë janë të fokusuar kryesisht në ofrimin e praktikave profesionale për studentët, në zhvillimin e leksioneve të hapura dhe prezantimet rreth përvojave të ndryshme nga tregu i punës.


GVJ: GVJ nisur nga kërkesa e Standardit I.2 dhe mungesa në DVV, rekomandon hartimin në mënyrë periodike nga Departamenti të një raporti analitik mbi përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

2. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.1:**

GVJ: Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e inxhinierisë së softuare. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Universiteti EPOKA ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut. GVJ konstaton se mungojnë module për Praktikën profesionale në lidhje me inxhinierin softueri. GVJ rekomandon: (1) Organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018; (2) Futja në kurrikul e praktikës profesionale në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D.

GVB: Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri” është licensuar me kurrikulën aktuale. Departamenti që ofron këtë program studimi, në këtë rast Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, ka bërë një kërkesë drejtuar “Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë” të Universitetit EPOKA për të shtuar Praktikën Profesionale në kurrikulën e këtij programi studimi. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është përgjigjur me shkresën Nr. Prot: 0700/22009 (lutemi referojuni Shtojcës Nr. 1) dhe ka shprehur se kjo kërkesë nuk aprovohet pasi, sipas Nenit 35, pika 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015, ndryshimet e kurrikulës së një programi studimi mund të kryhen vetëm pas akreditimit.



Gjithashtu, sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 dhe amenduar sipas VKM 185 datë 25.03.2021, një institucion i arsimit të lartë mund të bëjë ndryshime në kurrikulë vetëm për programet e akredituara. Departamenti do të përmbushë rekomandimin e GVJ për futjen e Praktikës Profesionale pasi ky program i studimit të marrë akreditimin e parë.

GVJ: Vlerësohet fakti që Departamenti i Inxhinierisë kompjuterike ka bërë kërkesë drejtuar “Komisionit të Përhershëm”.GVJ nisur nga kurrikula aktuale e vënë në dispozicion gjatë vlerësimit të programit rekomandon futjen e lëndës së Praktikës Profesionale në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018 dhe në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

3. Lidhur me komentën e institucionit për Standardi II.2:

GVJ: Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë zhvillon veprimtaritë e tij pjesërisht në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe standardet e cilësisë në Arsimin e Lartë, të reflektuara edhe në aktet rregullatore të Institucionit. GVJ rekomandon të rekrutohet staf me tituj e grada në mënyrë që ngarkesa mësimore e stafit të jetë më e ulët.

GVB: Duke ju falënderuar për rekomandimin tuaj, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është vazhdimisht në kërkim të punësimit të stafit cilësor dhe ka qenë i selektiv në procesin e rekrutimit. Gjatë vitit akademik aktual 2023-2024, është punësuar një staf akademik me titullin Profesor, një staf akademik me titullin Profesor i Asociuar dhe dy Asistentë Lektorë.


GVJ: GVJ për realizimin e ngarkesës në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, për realizimin e mësimdhënies me cilësi dhe për krijimin e hapësirave për angazhimin e stafit në kërkim shkencor rekomandon rekrutimin e stafit të ri për të krijuar mundësinë e rishpërndarjes së ngarkesës.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

4. Lidhur me komentën e institucionit për Standardi II.3:

GVJ: Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri” përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Institucioni kujdeset në përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve në përputhje me nevojat e tregut, ndryshimet më të fundit teknologjike dhe literaturën bashkëkohore. GVJ sugjeron që të përfshihen kredite për praktikën mësimore.

GVB: Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri” është licensuar me kurrikulën aktuale. Departamenti që ofron këtë program studimi, në këtë rast Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, ka bërë një kërkesë drejtuar “Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë” të Universitetit EPOKA për të shtuar Praktikën Profesionale në kurrikulën e këtij programi studimi. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është përgjigjur me shkresën Nr. Prot: 0700/22009 (lutemi referojuni Shtojcës Nr. 1) dhe ka shprehur se kjo kërkesë nuk aprovohet pasi, sipas Nenit 35, pika 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015, ndryshimet e kurrikulës së një programi studimi mund të kryhen vetëm pas akreditimit. Gjithashtu, sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 dhe amenduar sipas VKM 185 datë 25.03.2021, një institucion i arsimit të lartë mund të bëjë ndryshime në kurrikulë vetëm për programet e



akredituara. Departamenti do të përmbushë rekomandimin e GVJ për futjen e Praktikës Profesionale pasi ky program i studimit të marrë akreditimin e parë.

GVJ: GVJ rekomandon organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018, duke futur në kurrikul e “Praktikën profesionale” në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D.

Raporti në këtë pike nuk ndryshon.

5. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi II.4:**

GVJ: Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuare” krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturën bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave. GVJ rekomandon organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018, duke futur në kurrikul e “Praktikën profesionale” në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D.

GVB: Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri” është licensuar me kurrikulën aktuale. Departamenti që ofron këtë program studimi, në këtë rast Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, ka bërë një kërkesë drejtuar “Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë” të Universitetit EPOKA për të shtuar Praktikën Profesionale në kurrikulën e këtij programi studimi. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë” është përgjigjur me shkresën Nr. Prot: 0700/22009 (lutem referojuni Shtojca Nr. 1) dhe ka shprehur se kjo kërkesë nuk aprovohet pasi, sipas Nenit 35, pika 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015, ndryshimet e kurrikulës së një programi studimi mund të kryhen vetëm pas akreditimit. Gjithashtu, sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 dhe amenduar sipas VKM 185 datë 25.03.2021, një institucion i arsimit të lartë mund të bëjë ndryshime në kurrikulë vetëm për programet e akredituara. Departamenti do të përmbushë rekomandimin e GVJ për futjen e Praktikës Profesionale pasi ky program i studimit të marrë akreditimin e parë.

GVJ: GVJ rekomandon organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018, duke futur në kurrikul e “Praktikën profesionale” në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D.

Raporti në këtë pike nuk ndryshon.

6. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi IV.I Kriteri 5:**

GVJ: Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se nuk ka informacion lidhur me stafin ndihmës akademik të angazhuar në mbështetje të realizimit të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjes së laboratorëve.

GVB: Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike nxjerr thirrje për staf ndihmës në fillim të çdo semestri. Roli i stafit ndihmës është kritik në orët laboratorike dhe në mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve mësimore (lutemi referojuni Shtojcës Nr. 02). Stafi ndihmës i angazhuar në programin e studimit për Inxhinieri Softuerike është si vijon:

- Semestri vjeshtës 2022-2023-Griselda Alushllari-CEN 109-Introduction to Algorithms and Programming- 3 orë laborator javore
- Semestri Pranverës 2022-2023-Griselda Alushllari - CEN 110 -C Programming - 9 orë laborator javore
- Semestri vjeshtës 2021-2022- Alba Meça- CEN 109-Introduction to Algorithms and Programming- orë laborator javore
- Semestri Pranverës 2021-2022-Megi Kondi- CEN 110 -C Programming – 9 orë laborator javore
- Semestri Pranverës 2021-2022-Alba Meça - CEN 206-Data Structure - 6 orë laborator javore
- Semestri Pranverës 2020-2021-Erilda Muka - MTH 102-Calculus II -5 orë laborator javore

GVJ: Vlerësohet fakti që Universiteti Epoka, ka të angazhuar staf akademik ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratoreve.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

7. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi V.5 Kriteri 1:**

GVJ: Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në universitetin Epoka është ngritur Organi i Këshillit Studentor. Objektivi i Këshillit Studentor të Universitetit Epoka është të sigurojë zhvillim akademik të studentëve ashtu dhe rritjen e tyre sociale e personale.

GVJ nuk ka informacion nëse në këshillin studentorë të universitetit janë të angazhuar studentë të cilët ndjekin programin Inxhinieri Software.

GVB: Këshilli Studentor përbëhet nga përfaqësues të studentëve të zgjedhur në mënyrë demokratike për të përcjellë peticionet e studentëve në Administratën e Universitetit dhe për të kontribuar në aktivitetet arsimore të Universitetit. Në këshillin studentor ka dhe përfaqësues të studentëve nga programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri”. Lutemi referojuni tek web-sitet e mëposhtme,

Link: <https://dos.epoka.edu.al/cat-student-council-669.html>

2020-2021-Klea Xhina

2021-2022-Klea Xhina

2021-2022-Anita Mjeshtri

2022-2023- Tea Meraj


2022-2023- Anita Mjeshtri

2022-2023 - Klea Xhina

Lutemi referojuni edhe raporteve vjetore institucionale të cilët përmbajnë informacion në lidhje me anëtarët e këshillit studentor: <https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-for-mas-1479-2743.html> (2020-2021 faqe 11, 2021-2022 faqe 7, 2022-2023 faqe 91)

GVJ: Vlerësohet fakti që në këshillin studentor të universitetit janë të angazhuar studentë të cilët ndjekin programin Inxhinieri Software.

Raporti në këtë pikë ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Softuari”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e tij [<u>Evidencë 7, Neni 2, fq. 1</u>], Universiteti EPOKA ka mision të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. Universiteti EPOKA realizon misionin e tij përmes zhvillimit të arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente [<u>Evidencë 7, Neni 3, fq. 2</u>]. <u>Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf</u>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softuari” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e Universitetit Epoka për të formuar specialistë të lartë dhe përgatitur shkencëtarë të rinj [<u>Evidencë 7, Neni 3, fq. 2</u>] dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKSTI 2020), me Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë me Biznesin (BITS), me Strategjinë për TIK (miratuar me Vendim KM Nr. 2016, datë 10.04. 2003 dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim [<u>Evidencë 7, Neni 3, fq. 2</u>], përmes të cilës, në kuadër të interesit rajonal, Universiteti Epoka, synon, ndër të tjera, përgatitjen e individëve të mirëkualifikuar, produktivë, të orientuar drejt kërkimit shkencor dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare. <u>Evidencë 17, fq. 7</u> <u>Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf</u> <u>Annex 5.2-EPOKA University Mission.pdf</u>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit, si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i Studimeve Bachelor në SWE është mbështetur dhe hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të brendshëm të institucionit [<u>Evidencë 15 fq. 5</u>] dhe në përputhje me strategjinë e departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike [<u>Evidencë 16 fq. 2</u>], duke qenë një vazhdim i suksesshëm i programeve Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike (CEN), Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital (ECE).</p> <p>Ky program studimi është zhvilluar në bazë të nevojave të tregut të punës dhe në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.</p> <p>Annex 5-EPOKA University Strategy.pdf</p> <p>Annex 5.1-Department Strategic Plan.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Software” ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij [<u>Evidencë 6</u>].</p> <p>Gjatë vitit akademik 2022 – 2023, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka patur në përbërje të tij 17 personel akademik efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr; - 1 Prof. Asoc; - 5 Dr; - 10 MSc; <p>11 personel akademik me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Asoc. Dr; - 2 Dr; - 7 MSc; <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike disponon, në funksion të programeve të studimit që ofron, laboratorë bashkëkohore përmes të cilëve, studentët realizojnë orë të praktike në përputhje me programin e studimit dhe nevojat për aftësimin praktik të tyre [<u>Evidencë 71</u>].</p> <p>Summary Tables_BA_SWE_Annex 39.pdf</p> <p>Annex 28-Information on Infrastructure capacities.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Fusha e studimit të</p>

<p>përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Inxhinieri Softuare është përputhje akademike dhe kërkimore me gjashtë programet e tjera të studimit ofruara në departament, kryesisht programi SWE ka elemente të përbashkëta me degën Inxhinieri Kompjuterike dhe atë të Inxhinierisë Elektronike dhe Komunikimit Dixhital.</p> <p>Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Softueri" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale.</i></p> <p><i>Institucioni disponon infrastrukturën laboratorike dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Softueri".</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Softueri" realizohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, mbështetur në rregulloren e Universitetit Epoka [Evidencë 7] si dhe të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik nga fakultete të tjera të Epokës, si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësive respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre [Evidencë 19] [Evidencë 20] [Evidencë 21]. Marrëdhënia midis strukturave të ndryshme brenda Epokës, njësive të ndryshme administrative dhe akademike rregullohet përmes rregullores së brendshme të Institucionit [Evidencë 18].</p>

	<p>Analizat e vazhdueshme të punës së stafit akademik dhe administrativ e realizuar nga Institucioni, tregojnë rezultate shumë të kënaqshme referuar rezultateve të mbledhura nga analiza e formularëve të vlerësimit të lëndëve, analiza e strukturës së cilësisë së provimit si edhe procesin e vlerësimit të kurrikulës apo përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit të programeve [Evidencë 14].</p> <p>Annex 1.1-Basic Regulation.pdf</p> <p>Annex 7-Academic & Administrative Staff Recruitment form.pdf</p> <p>Annex 7.1-Regulation on Staff Recruitment.pdf</p> <p>Annex 7.2-Academic Staff Satisfaction Survey.pdf</p> <p>Annex 6-Regualtion in terms of autonomy, academic, financial frëdom.pdf</p> <p>Annex 4.1-Company Satisfaction Survey Reports.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit EPOKA ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase si: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu Durrës”, Univeristetit European i Tiranës, Universiteti Polis, Universiteti i New York Tirana, Universiteti i Tiranës, Western Balkans University, si dhe institucione të huaja të arsimit të lartë si: University of Montpellier i Francës, Bjelovar University of Applied Sciences së Kroacisë, Hoschule Fulda – University of Applied Sciences i Gjermanisë, University of Pelopennese i Greqisë etj. [Evidencë 65, Evidencë 66], të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara [Evidencë 28].</p> <p>Annex 22.1-List of partnership agrëments.pdf</p> <p>Annex 22.2-List of Agrëments with companies .pdf</p> <p>Annex 10.3-List of Students and Staff mobility toward and from study program].pdf</p>




<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të inxhinierive, si: Kineton Albania, ICRANet, Smartwork L.L.C, Softics Lab [Evidencë 66] etj.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit, dhe Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qëllim ekspozimin ndaj praktikave të studentëve [Evidencë 53]</p> <p>Annex 22.2-List of Agréments with companies .pdf Annex 19-Guidle on the conduct of professional practice.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike kujdeset për krijimin e mundësive për zhvillimin korrekt të praktikave profesionale për të gjithë studentët e tij, në përputhje me programin e studimit të ofruar [Evidencë 55].</p> <p>Për të analizuar arritjet dhe për të përcaktuar objektivat, kryhen raporte vjetore të realizuara nga Departamenti [Evidencë 70] dhe Raporte Vjetore Institucionale [Evidencë 4].</p> <p>Annex 19-Guidle on the conduct of professional practice.pdf Annex 26-Annual Report of CEN Department .pdf Annex 27-Raporti Vjetor 2021-2022.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</i></p> <p><i>EPOKA falë bashkëpunimeve me ente vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre.</i></p> <p><i>GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, konstaton që Institucioni nuk ka hartuar një raport analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbyshjes së standardeve të fushës	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri”, i ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike pranë Universitetit Epoka, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 6].</p> <p>Çdo lëndë i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Mbështetur në VKM-në e mësipërme, janë ndërtuar në përputhje të plotë edhe kurrikula dhe planprogramet e lëndëve.</p> <p>Summary Tables BA SWE Annex 39.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri” është zhvilluar në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve (KSHK), të dispozitave të ligjit numër 10247, datë 04.03.2010. Orientimi i programit të studimit SWE i specifikuar edhe në Statutin e Universitetit [Evidencë 7], demonstroi aftësi kërkimore të cilat janë të disponueshme në departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike.</p> <p>Objektivat kryesore formuese të këtij programi, mbështetur në Nivelin 6 në KSHK, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që një student i diplomuar në Bachelor në Inxhinieri Software duhet të plotësojë janë:</p> <p>a. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor me njohuri të avancuara në fushën e inxhinierisë softueri, duke përfshirë analizën kritike të teorive, parimeve, vlerësimeve</p>




<p>problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>të njohurive, mjeteve dhe pajisjeve si edhe kriterëve të performancës;</p> <p>b. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për aftësi të avancuara në inxhinierinë softueri duke demonstruar inovacion, zgjidhje të problemeve komplekse, përmirësimin e sigurimit të cilësisë;</p> <p>c. Përgatitja e specialistëve të kualifikuar për menaxhimin e aktiviteteve apo projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke i përgatitur për përgjegjësi vendimmarrje;</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [<u>Evidencë 6, fq. 16</u>]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 37 ECTS – 20.55 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 91 ECTS – 50.56%, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 30 ECTS – 16.67 % - Lëndë plotësuese (D) – 16 ECTS – 8.89 %, - Detyrime përmbyllëse (E) – 6 ECTS – 3.33 %. <p>GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndët ndërdisiplinore/integrese (C) duhet të jenë në masën 12-15% - Lëndët plotësuese (D) duhet të jenë në masën 12-15% <p><i>GVJ rekomandon rishikimin dhe shpërndarjen e krediteve sipas VKM Nr. 41.</i></p> <p>Summary Tables BA SWE Annex 39.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Softueri përputhet jo plotësisht me kërkesat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të ministrave nr. 41, date 24.01.2018 [<u>Evidencë 9</u>].</p> <p>Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) janë parashikuar 4 lëndë në lidhje me “Development of Reading and Writing Skills in English”, gjithsej 16 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 6 ECTS. [<u>Evidencë 6</u>].</p> <p>GVJ konstaton se mungojnë module për Praktikën profesionale në lidhje me inxhinierinë softuare.</p> <p>Nisur nga të dhënat e kurrikulës <i>GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018;</i>

	<p>- <i>Futja në kurrikul e praktikës profesionale në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D;</i></p> <p>Annex 2-Curricula of the study program.pdf</p> <p>Summary Tables BA_SWE Annex 39.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti EPOKA ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve vendas dhe të huaj [Evidencë 7, Neni 81-100, fq. 60-68; Evidencë 8, Neni 30-44, fq. 15-21] bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</p> <p>Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf</p> <p>Annex 1.1-Basic Regulation.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Universiteti EPOKA nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtesë.</p> <p>Universiteti është në proces të kodifikimit të programeve të studimit që ofrohen në të tre ciklet e studimit në përputhje me fushën specifike të studimit.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces.</p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softuari” nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë.</p>

Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Softuari" ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e inxhinierisë së softuare. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>Universiteti EPOKA ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se mungojnë module për Praktikën profesionale në lidhje me inxhinierinë softuare. <u>GVJ rekomandon:</u></i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018;</i> <i>2. Futja në kurrikul e praktikës profesionale në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D;</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2										
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.										
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve									
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si njësi kryesore është e përbërë nga këto njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Arkitekturës; 2. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; 3. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (25 pedagogë PAE) dhe 17 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë: <u>[Evidencë 3]</u></p> <table border="1" data-bbox="564 1729 1331 1935"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 1729 831 1825" rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2" data-bbox="831 1729 1331 1825">Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë</th> </tr> <tr> <th data-bbox="831 1825 1072 1881">PAE</th> <th data-bbox="1072 1825 1331 1881">PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 1881 831 1935">Prof.Dr</td> <td data-bbox="831 1881 1072 1935" style="text-align: center;">4</td> <td data-bbox="1072 1881 1331 1935" style="text-align: center;">-</td> </tr> </tbody> </table>		Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë		PAE	PAK	Prof.Dr	4	-
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë									
	PAE	PAK								
Prof.Dr	4	-								



Prof.Asoc	2	2
Dr/PhD	16	5
Msc	14	13
Gjithsej	36	20
	56	

Njësia bazë, Departamenti i Inxhnierisë Kompjuterike,, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	1	-
Prof. Asoc.	-	1	1	2
Dr./PhD.	5	2	5	2
Msc.	8	1	10	7
Totali	13	4	17	11

Nga sa më sipër Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV, takimi me GVB dhe Zyrën e Burimeve njerëzore në Institucion, GVJ konstaton se:

Ngarkesa e stafit të brendshëm me tituj dhe grada është e lartë.

Summary Tables BA_SWE Annex 39.pdf

Annex 9-Organizational Structure of EPOKA University.pdf

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike angazhon në kuadër të praktikave profesionale dhe laboratoreve staf akademik dhe ndihmës akademik me kualifikimet përkatëse për realizimin korrekt të tyre [Evidencë 7, Evidencë 35], duke përdorur udhëzimet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.

legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Koordinator për programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri” është Dr. F.S. Koordinator i programit zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 6; Evidencë 12]. Secilit grup studentësh, u caktohet një konsulent, i cili është pedagog pranë Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, dhe e udhëheq studentin në rrugëtimin akademik e shkencor [Evidencë 12, Neni 6, fq. 4]. Summary Tables BA_SWE Annex 39.pdf Annex 3-Regualtion of undergarduate study program.pdf			
Konkluzione	GVJ për realizimin e ngarkesës në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, për realizimin e mësimdhënies me cilësi dhe për krijimin e hapësirave për angazhimin e stafit në kërkim shkencor rekomandon rekrutimin e stafit të ri për të krijuar mundësinë e rishpërndarjes së ngarkesës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin [Evidencë 7]

<p>organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>dhe rregulloren e Universitetit [Evidencë 8], rregulloren e Studimeve dhe Provimeve Universitare [Evidencë 35].</p> <p>Informacionit të nevojshëm për organizimin dhe kurrikulën e programit paraqitet në Planin Strategjik të Departamentit [Evidencë 16] dhe publikohet gjithashtu në faqen zyrtare web të universitetit EPOKA: https://eis.epoka.edu.al/curricula.</p> <p>Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf</p> <p>Annex 1.1-Basic Regulation.pdf</p> <p>Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf</p> <p>Annex 5.1-Department Strategic Plan.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në planin mësimor [Evidencë 9] të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri”, si dhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 10] jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 12, Neni 14-16, fq. 6-7], si dhe risillen brenda syllabusit të çdo lënde [Evidencë 10]:</p> <p>Studenti që mungon në 25% të orëve të lëndës duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm.</p> <p>Secili syllabus përmban informacion në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Emri, kodi dhe kategoria e lëndës</i> • <i>Pozicioni i lëndës në afatin trevjecar (vit+semestër)</i> • <i>ECTS të lëndës dhe vlerat e krediteve</i> • <i>Kategoria e lëndës (A, B, C, D apo E)</i> • <i>Përcaktimin nëse është lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje</i> <p>Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes [Evidencë 10]:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Testimet e ndërmjetme</i> • <i>Laboratoret</i> • <i>Detyrat e kursit</i> • <i>Provimi përfundimtar.</i> <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:</p>

Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Koeficienti	Pikët
AA	4.00	10	90-100
BA	3.50	9	85-89
BB	3.00	8	80-84
CB	2.50	8	75-79
CC	2.00	7	70-74
DC	1.50	7	65-69
DD	1.00	5	60-64
FD	0.50	4	50-59
FF	0.00	0	0-49

[Annex 2-Curricula of the study program.pdf](#)

[Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf](#)

[Annex 3-Regualtion of undergarduate study program.pdf](#)

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Universiteti EPOKA ofron burime të ndryshme për t'i pajisur studentët me informacionet e nevojshme referuar kriterëve të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione jepen në:

- Rregulloren e Universitetit Epoka;
- Rregulloren e programit të studimit;
- Direktivën për Transferimin e studimeve;
- Si edhe në udhëzuesin “*Smart Student*”, i cili u ofron informacione të përditësuara për çdo vit akademik në lidhje me pranimin, regjistrimin apo transferimin;


Pranimi në programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri” është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm, që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM dhe aplikantët të cilët certifikojnë nivelin e duhur të anglishtes bazuar në certifikimet ndërkombëtare si TOEFL (IBT 68, CBT 190, PBT 520), IELTS me e madhe se 5.5 etj.

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike përcakton kriteret e pranimit për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softueri”, si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e

	<p>kandidatëve fitues. Kriteret e përcaktuara miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime.</p> <p>Annex 1.1-Basic Regulation.pdf Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf Annex 17.2-Directive on Student Transfer.pdf Annex 30-Smart Student Guide.pdf Evidencë 8, Neni 32–34, fq. 15–17, Neni 38, fq. 18, Neni 59-62, fq. 28] [Evidencë 35, Neni 5, fq. 3, Neni 7-9, fq.4, Neni 31-34, fq. 12-13]; [Evidencë 50]; [Evidencë 73].</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Evidencë 10], hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit për Inxhinieri Softuari nuk ka pësuar ndryshime bazuar në legjislacionin në fuqi, pasi programi duhet që të kalojë akreditimin e parë dhe më pas mund të propozojë ndryshime. Ndërkohë, në përputhje me Politikën e Universitetit EPOKA për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit [Evidencë 29] dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë Universitare EPOKA [Evidencë 45], bëhet një rishikim vjetor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Softuari, i cili përfshin vlerësimin e efektivitetit dhe identifikimin e fushave për përmirësim duke përfshirë modifikimet e kurrikulës [Evidencë 9].</p>
	<p>Annex 11-Policy on Continous improvment.pdf Annex 16-Quality Assurance Handbook.pdf Annex 2-Curricula of the study program.pdf</p>

Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Softueri" përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit.</i></p> <p><i>Instucioni kujdeset në përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve në përputhje me nevojat e tregut, ndryshimet më të fundit teknologjike dhe literaturën bashkëkohore.</i></p> <p>GVJ sugjeron që të përfshihen kredite për praktikën mësimore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në "Inxhinieri Softueri" është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 9, Evidencë 10]. Viti akademik është i organizuar në semestra.</p> <p>Përgjatë tre viteve të studimit, me anë të lëndëve të cilat zhvillohen, studentët përgatiten që të zbatojnë parimet inxhinierike në fushën e inxhinierisë së softuerit, kërkimit shkencor, por edhe për t'u pajisuar me aftësi për të punuar në grup dhe për të pasur role drejtuesi.</p> <p>Annex 2-Curricula of the study program.pdf</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [Evidencë 6, fq. 16]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 37 ECTS – 20.55 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 91 ECTS – 50.56%,




<p>programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 30 ECTS – 16.67 %, (Sipas VKM 41 duhet 12-15%) - Lëndë plotësuese (D) – 16 ECTS – 8.89 %, (Sipas VKM 41 duhet 10-15%) - Detyrime përmbyllëse (E) – 6 ECTS – 3.33 %. <p>Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 6 ECTS. Shpërndarja e lëndëve në semestra duke filluar nga lëndët formuese në vitin e parë, deri te ato bërthamë në vitin e dytë, e më tej në lëndët me zgjedhje bëhet sipas një rrjedhe logjike të programit përputhur me rezultatet e të nxënit të secilës lëndë [<u>Evidencë 6, fq. 25-27</u>].</p> <p><i>Nisur nga të dhënat e kurrikulës <u>GVJ rekomandon:</u></i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018,</i> 2. <i>Futja në kurrikul e praktikës profesionale në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D.</i> <p><u>Summary Tables BA SWE Annex 39.pdf</u></p> <p><u>Annex 2-Curricula of the study program.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit “Inxhinieri Softuari” ka një fokus të madh në aftësitë praktike, duke ofruar një raport të mirë të teorisë dhe praktikës me qëllim ofrimin e metodologjive më efektive për planifikimin, zhvillimin, testimin dhe mirëmbajtjes së softuarit [<u>Evidencë 9</u>], në përputhje edhe me programe të tjera studimi të suksesshme të inxhinierisë softuare.</p> <p><u>Annex 2-Curricula of the study program.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Universiteti EPOKA duke ofruar një kurrikul të pasur moderne me fokus në pjesët teorike dhe praktike, nxit një shkallë të lartë të punësimin, sidomos në studentët e viteve të treta. Studentët e degës “Inxhinieri Softuari” duke u pajisur me aftësi programuese e dizenujuese të softuare-it dhe duke pasur Anglishten si gjuhë studimi, bëhen të aftë në ndjekjen e studimeve të niveleve më të larta jo vetëm në institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, por edhe në universitete ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve [<u>Evidencë 29</u>] në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara jo</p>

<p>e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>vetëm nga ana e përmbajtjes, por edhe në lidhje me metodologjinë, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Ofrimi i programit në gjuhën angleze, e bën edhe më të lehtë përditësimin e literaturës me ato bashkëkohoret të viteve të fundit [Evidencë 77, Evidencë 78].</p> <p>Annex 11-Policy on Continuous improvment.pdf</p> <p>Annex 34-CEN Book Accreditation.pdf</p> <p>Annex 34.1-List of Books newly added in library.pdf</p>			
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softuari” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave [Evidencë 41], për t’u punësuar në fushën e zhvillimit të softuarëve, vendas dhe të huaj, në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë <i>Master Profesional</i> dhe <i>Master i Shkencave</i> në përputhje me profilin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si pjesë përbërëse e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierise në universitetit EPOKA, është në marrëdhënie të vazhdueshme me industrinë, për të përputhur programin e studimit me nevojën e tregut të punës [Evidencë 6].</p> <p>Annex 14-Diploma of the study program.pdf</p> <p>Summary Tables BA SWE Annex 39.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Software” krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturën bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon organizimin e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018, duke futur në kurrikulë “Praktikën profesionale” në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Mënyra se si programi i studimit, si pjesë e Departamentit të Inxhinierive kryen matjen e kënaqësisë së studentëve të diplomuar është e tillë që, Zyra e Planifikimit të Karrierës së Alumnit (ZKPA) nën Dekanin e Zyrës së Studentëve (DOS) kryen “Sondazhin e Kënaqshmërisë së Kompanisë” [Evidencë 29].</p> <p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softuari” është në procesin e tij të parë të akreditimit dhe rezultatet e sondazhet nuk janë ende të disponueshme. Gjithashtu, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, bën pjesë Forumi i Palëve të Interesit, i cili është një bord i ri këshillues i jashtëm i përbërë nga shatë anëtarë të cilët përfaqësojnë subjektet e biznesit, institucionet financiare, të diplomuarit dhe studentët. Misioni i këtij formimi është të sigurojë që programet e studimit përmbushin kërkesat e sektorit privat e të përditësojë kurrikulat në mënyrë të tillë që t’u ofrojë studentëve aftësitë e nevojshme për të qenë të aftë në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar.</p> <p>Annex 11-Policy on Continous improvment.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 35], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 13].</p> <p>Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit të studimit kryhen në disa drejtime:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Nëpërmjet kryerjes së “Sondazhit të të Diplomuarve” nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit, ku studentët mund të japin sugjerime për përmirësime të mëtejshme të kurrikulës;2. Përfshirja në senatin akademik, organin më të lartë vendimmarrës, të kryetarit të këshillit studentor dhe nënkryetarit të parë;3. Përfshirja në komisionin e përhershëm për sigurimin e cilësisë të nënkryetarit të Këshillit studentor për Cështjet e Sigurimit të Cilësisë;



	<p>4. Njëpërmjet sondazhit të vlerësimit të instruktorëve të lëndës [Evidencë 33].</p> <p>Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf</p> <p>Annex 4-Alumni Survey 2019-2020.pdf</p> <p>Annex 12.3- Course Instructor Evaluation Survey.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka autonomi organizative për t'u angazhuar vazhdimisht në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare [Evidencë 7, neni 4, pika 2c, fq. 7], duke ofruar mundësi për krijimin e rrjeteve dhe nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit (MoU) me institucione publike/jopublike, institucione të arsimit të lartë kombëtare/ndërkombëtare apo organizata të ndryshme [Evidencë 65, Evidencë 66].</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka aplikuar në pesë projekte të Kërkimit dhe Inovacionit Horizon 2020 dhe Horizon Europe, të cilat kishin fokus të vecantë në mjekësi, duke bashkëpunuar me institucione prestigjioze ndërkombëtare si: Nottingham University, Spartha medical, Dublin City University, Aalto University, French Governmental Research Institute CEA Leti, French Center of Medical Research (INSERM), University of Liege. Prej viztave të bashkëpunimit kërkimor dhe bashkëveprimit me ortakët dhe palët e interesuara, u morën në konsideratë propozimet e tyre për përmirësimin dhe përshtatjen e programit.</p> <p>Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf</p> <p>Annex 22.1-List of partnership agréments.pdf</p> <p>Annex 22.2-List of Agréments with companies .pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni nxiti përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Ngarkesa në auditor e studentëve [Tabela 13] është e organizuar në leksione (1216 orë), seminare (304 orë), ushtrime/laboratorë (432 orë), forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (0 orë), praktikë profesionale (0 orë) dhe udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (16 orë), gjithsej 1968 orë. Metodologjitë e mësimdhënies së përdorura në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Softuari” përshkruhen në Planprogramin e lëndëve në “Kurrikulën e programit të studimit të programit” [Evidencë 9], ku përfshihen aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione në auditor; - Seminare të cilat mund të organizohen në auditor apo laborator; - Laboratore; - Seanca praktike profesionale të zhvilluara në auditor - Prezantime në baza javore për lëndët për lëndët e bazës së projektit; - Detyra javore; - Leksionet të hapura; <p style="text-align: center;">Annex 2-Curricula of the study program.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Mësimdhënia në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softuari” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale [Evidencë 10], e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional.</p> <p>Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike parashikon gjatë gjithë vitit akademik konsulta të vazhduara të pedagogëve me studentët për plotësimin e nevojave të tyre [Evidencë 12, neni 6, neni 14]. Studentët gjithashtu mund të kontaktojnë këshillëtarin e tyre akademik për të vepruar si</p>

	<p>ndërmjetës në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në kuadrin e mësimdhënies.</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p> <p>Annex 3-Regulation of undergraduate study program.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti EPOKA, dhe në mënyrë të veçantë Departamentin i Inxhinierisë Kompjuterike, mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) [Evidencë 65] i kanë shërbyer përmirësimin të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike.</p> <p>Institucioni ndjek politika të tilla, që ofron trajnime të ndryshme apo leksione të hapura për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mësimdhënies [Evidencë 24].</p> <p>Stafi akademik inkurajohet duke u mbështetur financiarisht për pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare apo publikime në revista, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur interesin e tyre në kërkimin shkencor [Evidencë 61, Evidencë 64].</p> <p>Për përmirësimin e zhvillimit të procesit mësimor, Departamenti i Inxhinierive, nëpërmjet zyrës së ZKTIK ofron infrastrukturë të konsoliduar IT për Shërbimet Mësimore duke përmendur (1) Sistemin Interaktiv Epoka; (2) Rrjetin; (3) Shërbimet Google; (4) Mirëmbajtja e pajisjeve dhe përmirësimet e programit; (5) smart cards etj. [Evidencë 71].</p> <p>Annex 22.1-List of partnership agreements.pdf</p> <p>Annex 8.2-List of training activities organized at institutional level and delivered to all all the staff of the study program.pdf</p> <p>Annex 21.2-Directive on the promotion of scientific research.pdf</p> <p>Annex 21.5-List of publication of staff and students of the department and study program financially supported by the university.pdf</p> <p>Annex 28-Information on Infrastructure capacities.pdf</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit tek studentit mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Sofueri” është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilit, duke sjellë eksperiencën e tyre si mësimdhënës në Universitetin EPOKA [Evidencë 19, 20].</p> <p>Aplikanti për staf akademik testohet për kompetencat e tij përmes një leksioni të hapur rezultatet e të cilit plotësohen në “Formularin e Vlerësimit të Leksioneve të hapura” për këtë kandidat [Evidencë 34]. Departamenti është përgjegjës që të bëjë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik [Evidencë 11, Evidencë 6, fq. 22].</p> <p>Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.</p> <p>Annex 7-Academic & Administrative Staff Recruitment form.pdf</p> <p>Annex 7.1-Regulation on Staff Recruitment.pdf</p> <p>Annex 12.4-Open Lecture Assesment Form.pdf</p> <p>Annex 2.2-CV's of academic staff.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 6,12], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 33], të cilat zhvillohen në mënyrë të përsëritur, 2 herë në çdo semestër përpara testimit përfundimtar.</p> <p>Varësisht rezultateve të pyetësorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i departamentit përgatit një Raport të detajuar dhe Plan Veprimi [Evidencë 67], i cili i përcillet Zyrës së Rektoratit dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; - Përgjegjësi zhvillon takime individuale me pedagogët vlerësimi i të cilëve është nën mesatare apo që kanë komente shqetësuese nga studentët;




	<p>- Organizohen trajnime dhe seminare të ndryshme në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies [Evidencë 24].</p> <p>Summary Tables BA_SWE Annex 39.pdf</p> <p>Annex 3-Regualtion of undergarduate study program.pdf</p> <p>Annex 12.3- Course Instructor Evaluation Survey.pdf</p> <p>Annex 23-Academic Senate decision on the Action Plan.pdf</p> <p>Annex 8.2-List of training activities organized at institutional level and delivered to all all the staff of the study program.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në Universitetin EPOKA funksionon Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, njësi e cila është e përbërë nga Komisioni i Përhershëm Për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) [Evidencë 7, neni 35 & neni 37; Evidencë 46]. me nënjesitë e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimeve dhe Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë [Evidencë 30, Evidencë 45, Evidencë 47].</p> <p>Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike [Evidencë 10].</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik [Evidencë 15].</p> <p>KPSC-ja në fillim të çdo viti akademik realizon Kalendarin e Ngjarjeve dhe Aktiviteteve për të kryer trajnime të rregullta për zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve, Fakulteteve dhe Zyra Koordinuese e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ZKTIK) [Evidencë 94, Evidencë 24, Evidencë 86].</p>
	<p>Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf</p> <p>Annex 16.1-Regulation on the Organization and Functioning of pcqa.pdf</p>

	<p>Annex 12-Directive on Academic and Administrative performance assesment and quality imporvment.pdf</p> <p>Annex 16-Quality Assurance Handbook.pdf</p> <p>Annex 16.2 EPOKA University quality policy.pdf</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p> <p>Annex 5-EPOKA University Strategy.pdf</p> <p>Annex 48-Annual Report on Quality Assurance Activities of the PCQA.pdf</p> <p>Annex 8.2-List of training activities organized at institutional level and delivered to all all the staff of the study program.pdf</p> <p>Annex 40-Example of Documents on Training events.pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>Universiteti EPOKA kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Format e kontrollit të dijeve në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar me seminare workshope, frekuentime e studime laboratorike.</p> <p>Pas përfundimit të procesit të regjistrimit studentët pajisen nga Zyra e Regjistrimit me "Udhëzuesin Smart Student" [Evidencë 73], me anë të së cilës informohen mbi politikat, proceset dhe mekanizmat që drejtojnë studimet e tyre. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimin [Evidencë 10].</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët	

informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Në rregulloren mësimore [Evidencë 12, Neni 17-29, fq. 6-11] dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes [Evidencë 10]:

- Testimet e ndërmjetme
- Labororet
- Detyrat e kursit
- Provimi përfundimtar.

Në total student/i mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:

Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Koeficienti	Pikët
AA	4.00	10	90-100
BA	3.50	9	85-89
BB	3.00	8	80-84
CB	2.50	8	75-79
CC	2.00	7	70-74
DC	1.50	7	65-69
DD	1.00	5	60-64
FD	0.50	4	50-59
FF	0.00	0	0-49

Planprogramet e secilës lëndë publikohen gjithashtu në faqen e Internetit të Universitetit EPOKA (<https://eis.epoka.edu.al/curricula/83/program>).

[Annex 30-Smart Student Guide.pdf](#)

[Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf](#)


[Annex 3-Regualtion of undergraduate study program.pdf](#)

Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë

<p>studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>6, Evidencë 12], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 33].</p> <p>Summary Tables BA SWE Annex 39.pdf</p> <p>Annex 3-Regualtion of undergraduate study program.pdf</p> <p>Annex 12.3- Course Instructor Evaluation Survey.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike vendos në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve infrastrukturën e nevojshme teknologjike për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies me qëllim realizimin e objektivave formues të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës [Evidencë 86, Evidencë 10]. Përfshirja e studentëve, nën mbikqyrjen e pedagogëve të lëndëve, në rindërtimin e situatave reale në laborator përmes pajisjeve laboratorike në dispozicion, i aftëson në profesion dhe inkurajon sensin e tyre të autonomisë.</p> <p>Me qëllim promovimin shkencor, Universiteti Epoka, përvec trajnimeve të ndryshme të stafit akademik, ofron edhe stimuj financiarë për t'i mbështetur ata në pjesëmarrje të ndryshme konferencash apo edhe në publikime revistash kombëtare/jokombëtare [Evidencë 61].</p> <p>Annex 40-Example of Documents on Training events.pdf</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p> <p>Annex 21.2-Directive on the promotion of scientific research.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimin të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi III.3</p>	
<p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Vlerësimi përfundimtar është kombinim i vlerësimeve të ndryshme, të specifikuara nga pedagogu i lëndës. [Evidencë 10; Syllabuse]:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>provimi i ndërmjetëm</i> • <i>detyrat e kursit</i> • <i>laboratore</i> • <i>quize/projekte</i> • <i>provimi përfundimtar</i> <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë sipas përcaktimeve në Standardin III.2, Kriteri 1.</p> <p><u>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimiit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti EPOKA vë në zbatim sistemin interaktiv EPOKA (EIS) për t'u ofruar studentëve mundësi në lidhje me menaxhimin e procedurave për lëndën, si notat, frekuentimin, transkriptin apo përzgjedhjen e lëndëve duke ofruar transparencë për studentët, pedagogët, koordinatorin dhe drejtuesin e departamentit [Evidencë 38].</p> <p>Provimet kryhen në formatin e testeve në kopje fizike, ku studentët marrin një kod të personalizuar të cilin e di vetëm studenti dhe koordinatori i departamentit, me qëllim që të ruhet anonimiteti dhe të shmangen forma të ndryshme abuzimi [Evidencë 39].</p> <p><u>Annex 13.3-Decision of the rectorate of EPOKA University No.04, dated 05.11.2019 on exam autonomy.pdf</u></p> <p><u>Annex 13.4-Exam Anonymity Process.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Vlerësimi përfundimtar është kombinim i vlerësimeve të ndryshme, të specifikuara nga pedagogu i lëndës. [Evidencë 10; Syllabuse]</p> <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë sipas përcaktimeve në Standardin III.2, Kriteri 1.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me</p>	<p>Procesi i vlerësimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në planprogramin e lëndës [Evidencë 10], Rregulloren e Universitetit EPOKA për “Studimet universitare dhe provimet” [Evidencë 35, Neni 20] dhe “Udhëzuesin për provimet”</p>

<p>komente/fëdback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>[Evidencë 36]. Në orën pasardhëse të mësimit personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura.</p> <p>Pedagogët në Programin “Inxhinieri Softuari” për të vlerësuar kompetencat dhe aftësitë e studentëve në bazë të kriterëve të ndryshme përdorin “Formularin e Vlerësimit” [Evidencë 95], komentet e të cilit ndahen me studentët. Gjithashtu, bazuar në “Direktivën për Funksionimin e Bordit të Provimeve” [Evidencë 40], Dekanati cakton një ekspert për programin “Inxhinieri Softuari”, që të vlerësojë cilësinë e provimeve.</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p> <p>Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf</p> <p>Annex 13.1-Guideline on Examniation.pdf</p> <p>Annex 49-Exam Assesment Form.pdf</p> <p>Annex 13.5-Directive on the functioning of the exam board.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në përputhje me “Udhëzuesin për Provimet” [Evidencë 36]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës; 2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi; 3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit; <p>Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës dhe informohet instrukturi i kursit dhe Shefi i Departamentit. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi, i cili vlerësohet me 0 pikë. Universiteti EPOKA për të shmangur plagjiaturën e mashtrimin, në Rregulloren “Për disiplinën e studentëve” [Evidencë 37, Neni 5(d), 6(i) dhe 8(m)] përkrahur masat që merren për këtë shkelje disiplinore në detyrat e kursit, projektet apo tezat e diplomave bachelor e master.</p>

	<p>Për parandalimin e plagjiaturës universitetit përdor softuerin Turinitin, i cili është një ndër softet që ofrohet nga Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit të Universitetit [Evidencë 71, Evidencë 84]</p> <p>Annex 13.1-Guideline on Examniation.pdf</p> <p>Annex 13.2-Regulation on Student Discipline.pdf</p> <p>Annex 28-Information on Infarstructure capacities.pdf</p> <p>Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Brenda afateve të përcaktuara prej Universitetit, nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar, personeli akademik i lëndës hedh në sistemin EIS notat e secilit student varësisht nga ID-ja e studentit, e cila dihet vetëm prej studentit dhe koordinatori i departmantit për të ruajtur anonimitetin [Evidencë 39]. Kështu pedagogu konverton ID-në në emër të studentit, vetëm pasi notat janë hedhur në sistem. Më pas personeli akademik dorëzon pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve, si dhe tezat e korrigjuara së bashku me tezat origjinale në një zarf të mbyllur.</p> <p>Annex 13.4-Exam Anonymity Process.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin, duke dorëzuar një kërkesë ankimimi notash [Evidencë 42] në Zyrën e Regjistruesit. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studentit, jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të grupit mësimor. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Departamenti propozon vendimin përfundimtar, i cili përfundimisht caktohet nga Dekanati. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet [Evidencë 43].</p>
	<p>Procedura e rishikimit të notës përshkruhet qartë në Udhëzuesin Smart Student [Evidencë 73, fq. 41], Rregulloren e Universitetit EPOKA “Për studimet dhe provimet universitare” [Evidencë 35, neni 25], dhe Direktiva e</p>



	<p>Universitetit EPOKA “Për funksionimin e Bordit të Provimeve” [Evidencë 40].</p> <p>Annex 15-Grade Appeal Form.pdf</p> <p>Annex 15.1-Procedure on Students Complaints in terms of grade appeal.pdf</p> <p>Annex 30-Smart Student Guide.pdf</p> <p>Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf</p> <p>Annex 13.5-Directive on the functioning of the exam board.pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit.</i></p> <p><i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit i ciklit të parë <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri”, siç dëshmohet edhe në “Kurrikulat” e lëndës [Evidencë 9] ka për mision:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. T’u ofrojë studentëve mundësinë që të marrin dhe zhvillojnë dijet, si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e inxhinierisë së softuerit; 2. Të nxisë tek studentët të menduarit dhe analizuarit kritik për të kuptuar sfidat në situata të ndryshme të zhvillimit të softuereve; 3. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe logjistike në fushën e programimit dhe inxhinierisë softueri;

	Annex 2-Curricula of the study program.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit [Evidencë 6], komunikimit dhe ndërveprimit social [Evidencë 10] duke qenë se sektori informatik është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit. Për më tepër planprogrami ofron lëndë si: “Aftësitë e Komunikimit” apo lëndë me zgjedhje si “Hyrje në biznes” apo “Hyrje në Drejtësi” të cilat e ndihmojnë studentin në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Summary Tables BA_SWE Annex 39.pdf</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.	<p>Gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara [Evidencë 10].</p> <p>Direktiva e Universitetit Epoka “Për Funkcionimin e Bordit të Provimeve” urdhëron çdo fakultet të caktojë një ekspert për çdo program studimi për të vlerësuar cilësinë e provimeve [Evidencë 83, Evidencë 95].</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p> <p>Annex 36-EIS Guideline lecturer-student.pdf</p> <p>Annex 49-Exam Assesment Form.pdf</p>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në	<p>Kurrikula e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri” [Evidencë 10] është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e softuerëve.</p> <p>Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre.</p> <p>Studentët kanë akses në infrastrukturën e nevojshme si:</p>

<p>interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Infrastruktura në Funkcionin e Programit të Studimit [Evidencë 71]; - Shërbimet e Bibliotekës [Evidencë 80]; - Shërbimet IT [Evidencë 84]. <p>Bashkëpunimet e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere [Evidencë 65, Evidencë 66].</p> <p>Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf</p> <p>Annex 28-Information on Infrastructure capacities.pdf</p> <p>Annex 34.3-Information on Library Services.pdf</p> <p>Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf</p> <p>Annex 22.1-List of partnership agreements.pdf</p> <p>Annex 22.2-List of Agreements with companies .pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike zhvillon vazhdimisht leksione të hapura me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjell tek studentët zhvillimet më të fundit në fushën e inxhinierisë së softuerit, brenda dhe jashtë vendit [Evidencë 64].</p> <p>Annex 21.5-List of publication of staff and students of the department and study program financially supported by the university.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Softueri" është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e zhvillimit të softuerit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Softueri” përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi [Evidencë 35, Neni 16].</p> <p>Nëse studenti/ja e ka mesatren e notave kumulative (CGPA) nen 3.00, ai duhet t’i nënshtrohet lëndës së Provimit Gjithëpërfshirës Përfundimtar [Evidencë 96], i cili përmban 6 lëndë bazë dhe përbëhet nga 25 pyetje të barabarta, ku secila lëndë përfaqësohet nga një pyetje teorike, dy pyetje për zgjidhjen e problemeve dhe një pyetje me zgjidhje shumëfishe.</p> <p>Nëse studenti/ja e ka mesatren e notave kumulative (CGPA) midis 3.00 dhe 4.00 atëherë ai/ajo mund të zgjedhë që të zhvillojë lëndën e Projektit të Diplomimit.</p> <p>Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf</p> <p>Annex 50-Decision of the senate regarding FCE.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike përcakton listën e temave të diplomave (Projektin e Diplomimit) dhe programet e lëndëve bazë për Provimet Përfundimtare Gjithëpërfshirëse në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik [Evidencë 96]. Studentët, pasi njihen me programin e Provimit Përfundimtar Gjithëpërfshirës, asistohen nga koordinatori dhe mentorët e programit të studimit, si dhe pedagogët e lëndëve me informacione, udhëzime dhe materiale në funksion të mbarëvajtjes së tij. Gjithashtu udhëzimet gjithëpërfshirëse mund të gjenden në faqen e internetit të departamentit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për provimin e plotë përfundimtar: https://cen.epoka.edu.al/home-final-comprehensive-exam-1919-1920.html - Për punimin e diplomës: https://cen.epoka.edu.al/home-thesisguidelines-385-594.html <p>Annex 50-Decision of the senate regarding FCE.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë</p>	<p>Në provimin përfundimtar të mbrojtjes së diplomës përfshihen lëndët karakterizuese të programit përkatës, pra, të gjitha lëndët e veprimtarisë B. Mund të përfshihen lëndë të kategorisë C në ato raste kur janë të profilit profesional të programit.</p>

<p>gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Pesha që zë secila prej lëndëve në përmbajtjen e tezës së provimit, përcaktohet mbi bazën e krediteve të lëndëve. Komisioni harton një tabelë me pikët përkatëse që do të ketë secila lëndë në vlerësimin e përgjithshëm prej 100 pikësh sipas peshës në kredite të secilës lëndë [Evidencë 96].</p> <p>Provimi Përfundimtar Gjithëpërfshirës përmban 6 lëndë bazë dhe përbëhet nga 25 pyetje të barabarta, ku secila lëndë përfaqësohet nga një pyetje teorike, dy pyetje për zgjidhjen e problemeve dhe një pyetje me zgjidhje shumëfishe.</p> <p>Annex 50-Decision of the senate regarding FCE.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka hartuar një procedurë për përzgjedhjen e temës së diplomës nga ana e studentëve, ku në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik ofrohet një listë me tema kërkimore që përputhen me ekspertizen e nevojshme, prej të cilave studenti ka të drejtë të zgjedhë tre preferenca për mbikëqyrësin e tezës së tyre të diplomës.</p> <p>Pas përfundimit të këtij procesi, udhëheqësi ndihmon studentin në zhvillimin e idesë fillestare, kryerjen e studimit të literaturës, përcaktimin e metodologjisë, implementimin dhe testimin e rezultateve. Procesi i paraqitjes përfundimtare të temës së diplomës përcaktohet në “Udhëzuesin për shkrimin e tezës” (https://cen.epoka.al/home-thesis-guidlines-385-594.html).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën shkencore për të inkurajuar studentët drejt kërkimit shkencor, praktikave, apo kryerjeve të implementimeve apo testeve të ndryshme në lidhje me inxhinierinë e softuerit. Infrastruktura shkencore e ofruar përfshin: [Evidencë 71, Evidencë 80, Evidencë 84]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Infrastruktura në funksion të programit të studimit; - Shërbimet e bibliotekës; - Shërbimet e IT-së; - Aksesin në burime online të revistave shkencore; - Programe softuerike specifike të nevojshme për lëndët e tyre; <p>Annex 28-Information on Infrastructure capacities.pdf</p> <p>Annex 34.3-Information on Library Services.pdf</p>

	Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi i formimit apo teza e diplomimit vlerësohet me notë, njëlloj si lëndët e tjera. Në provimin gjithëpërfshirës përfundimtar, secila lëndë ka peshën e saj mbi bazën e krediteve përkatëse në vlerësimin e përgjithshëm prej 100 pikësh.			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë "Bachelor" në "Inxhinieri Softuari" në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, të Universitetit EPOKA, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Bazuar në Rregulloren për studimet universitare.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.			
Konkluzione	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Softuari" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të gjithëpërfshirës përfundimtar/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kriteret e tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi.</i></p> <p><i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë "Bachelor" në "Inxhinieri Softuari" në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, të Universitetit EPOKA, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i></p> <p><i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1								
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve							
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se departamenti përgjegjes për këtë program studimi mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihet personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme që angazhohet cdo vit, lëndët modulet që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për cdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale. Referuar Evidenca Tabela Përmbledhëse RVB BA SËE shqip.pdf, tab 6.1-6.3], stafi akademik i angazhuar në programin e studimit përgjatë tre viteve akademike ka kualifikimin si më poshtë:							
	Tituj/grada		2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
			PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
	Prof.Dr		-	-	-	-	1	-
	Prof.As.Dr		-	-	-	1	1	2
	Dr/PhD		2	1	5	2	5	2
	Msc		5	-	9	2	10	7
Në total		5	1	14	5	17	11	
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se universiteti ka një rregullore të brendshme në të cilën përcaktohet procedura e rekrutimit të stafit të ri.							

studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Cdo fillim viti akademik zyra e burimeve njerëzore në bashkëpunim me fakuletet dhe departamentet koordinon punën për rekrutimin dhe shpërndarjen e stafit akademik duke u mbështetur në direktiven e universitetit Epoka “Për ngarkesën mësimore”.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, [Tabela Përmbledhëse RVB BA SËE shqip.pdf, tab 12.1-12.3](#)], ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, sipas të dhënave më poshtë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2020-2021	85 %
2021-2022	84 %
2022-2023	76 %

Për sa më sipër rezulton se ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

[Evidenca [Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf](#)]

[Evidenca [Annex 42-Directive on teaching load.pdf](#)]

[Evidenca [Summary Tables BA SWE Annex 39.pdf](#)]

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.


Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka kontrata pune me secilin punonjës të stafit akademik.

Cdo fillim viti burimet njerëzore në bashkëpunim me departamentin dhe fakultetin përgjegjës për programin Inxhinieri Software përditësojnë listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punës, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, cv, diploma, kualifikime etj. U verifikuan dy praktika në të cilën ishin specifikuar përveç kriterëve të përgjithshme në bazë të kuadrit ligjor në fuqi dhe kriteret specifike të lidhura me fushën e ekspertizës që duhet të mbulojë personeli akademik. Nga verifikimet rezulton që personeli

	<p>akademik përgjithësisht angazhohet në fushën e tyre të ekspertizës.</p> <p>Kohëzgjatja e kontratës së punës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm ishin me kohë zgjatje të ndryshme, përkatësisht me kohëzgjatje të pa përcaktuar, njëvjeçare, semestrale etj. Për stafin akademik me kohë të plotë kontratat e punës për kategorinë profesor dhe pedagog ishin me afat të pa përcaktuar, ndërsa për kategorinë asistent pedagog kontratat ishin një vjeçare me te drejtë rinovimi ndërsa për stafin me kohë të pjesshme përgjithësisht kontratat ishin semestrale në vartësi të nevojave të njëjësive bazë dhe kryesore përkatëse. Rinovimi i kontratës bëhet në bazë të rezultateve dhe vlerësimit cilësor në fushën e mësimdhënies, punës kërkimore, si dhe duke kontribuar në mbështetjen dhe zhvillimin e institucionit.</p> <p>[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]]</p> <p>[Evidenca Annex 1.1-Basic Regulation.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 38- Sample of employment contract.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se procesi i rekrutimit të stafit fillon në bazë të përcaktimeve të parashikuara në rregulloren për rekrutimin e stafit e cila zbatohet nga zyra e burimeve njerëzore.</p> <p>Në vartësi të nevojave të departamentit dhe miratimit të tyre nga Bordi i Administrimit, fakulteti i paraqet njësisë së burimeve njerëzore kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit. U verifikuan dy praktika dhe procedura e rekrutimit dhe vlerësimit zhvillohet si më poshtë:</p> <p>Zyra e burimeve njerëzore e shpall vëndin vakand në faqen zyrtare të universitetit, në portalin duapune.com si dhe në dy agjensi ndërkombëtare punësimi www.akadeus.com dhe www.jobs.ac.uk.</p> <p>Aplikantet ftohen të dergojnë online dokumentacionin e specifikuar në thirrjen e shpallur. Në qoftë se aplikanti ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar ai kalon në statusin e kandidatit dhe dosja i kalohet për vlerësim departamentit. Nëse komisioni i ngritur nga departamenti e vlerëson dosjen të përshtatshme zhvillohet intervistë dhe një leksion i hapur. Më pas komisioni ja përcjellë vendimin nëpërmjet dekanit rektoratit. Në bazë të vendimit të rektoratit, bordi administrativ miraton emërimin e kandidatit në vëndin e lirë të punës.</p>

	<p>[Evidenca Annex 1.1-Basic Regulation.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 7-Academic & Administrative Staff Recruitment form.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 7-Academic & Administrative Staff Recruitment form.pdf]</p> <p>[Evidenca https://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html]</p> <p>[Evidenca www.duapune.com]</p> <p>[Evidenca www.akadeus.com]</p> <p>[Evidenca www.akadeus.com]</p> <p>[Evidenca www.jobs.ac.uk]</p> <p>[Evidenca Annex 12.4-Open Lecture Assesment Form.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se stafi ndihmës i angazhuar në programin e studimit për Inxhinieri Softuerike është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Semestri vjeshtës 2022-2023-Griselda Alushllari-CEN 109-Introduction to Algorithms and Programming- 3 orë laborator javore • Semestri Pranverës 2022-2023-Griselda Alushllari - CEN 110 -C Programming - 9 orë laborator javore • Semestri vjeshtës 2021-2022- Alba Meça- CEN 109-Introduction to Algorithms and Programming- orë laborator javore • Semestri Pranverës 2021-2022-Megi Kondi- CEN 110 -C Programming – 9 orë laborator javore • Semestri Pranverës 2021-2022-Alba Meça - CEN 206-Data Structure - 6 orë laborator javore • Semestri Pranverës 2020-2021-Erilda Muka - MTH 102-Calculus II -5 orë laborator javore <p>[Evidenca: Annex 2]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në zyrën e Burimeve njerëzore ndodheshin të arkivuara dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Dokumentacioni përditësohet çdo vit në zyrën e burimeve njerëzore. Ruajta e të dhënave bëhet duke mbajtur një</p>

<p>përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>dosje fizike për cdo anëtar të stafit të Epokës, si dhe duke mbajtur një dosje elektronike në systemin Interaktiv Epoka.</p> <p>[Evidenca Vizita ne NBNJ]</p> <p>[Evidenca www.eis.epoka.edu.al/login]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë si brenda dhe jashtë vendit, me institucione publike dhe private etj.</p> <p>Universiteti Epoka ka bashkëpunime me universitete te BE-së në kuadër të programeve/projekteve:</p> <p>Erasmus +</p> <p>Tempus</p> <p>Horizont</p> <p><i>Por deri aktualisht studentët e programit Inxhinieri Software nuk janë të angazhuar në ndonjë projekt me karakter ndërkombetarë.</i></p> <p>Në kurrikulën e programit të studimit Inxhinieri Software nuk është përfshirë praktika profesionale. Megjithatë nga takimi me student ata u shprehën që gjatë studimeve të tyre bachelor ato janë ndërmjetësuar nga Zyra e Planifikimit të Karrieres dhe Alumnit për tu angazhuar në intership-e të paguara ose jo, së paku për një periudhë 3-6 mujore ose për tu punësuar nga kompani që institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga zyra e Planifikimit dhe Karrierës nuk ka evidenca konkrete.</p>
	<p>Gjithashtu për ti qasur studentët me tregun e punës institucioni organizon cdo vit Panairin e Punës.</p> <p><i>GVJ sygjeron përfshirjen e praktikës profesionale si modul i detyruar për tu kryer gjatë studimeve bachelor përpara</i></p>



	<p><i>procesit të diplomimit, si një mundësi për studentët që të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre, si dhe të lidhen me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p>[Evidenca Annex 22.1-List of partnership agreements.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 10.3-List of Students and Staff mobility toward and from study program].pdf]</p> <p>[Evidenca https://cpao.epoka.edu.al/events.html?lang=EN&dpid=5]</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton së programi i studimit Inxhinieri Software nuk ka të përfshirë në kurrikul praktike profesionale, ndaj GVJ nuk mund të shprehet për këtë kriter.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ku bën pjesë programi i studimit "Inxhinieri Software" për të realizuar veprimtarinë e tij akademike ka personel akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, ka rregullore për rekrutimin e stafit akademi. Universiteti Epoka ka marrëveshje bashkëpunimi me insitucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Universiteti Epoka është pjesë e projekteve/programeve ndërkombëtare. Universiteti Epoka bashkëpunon me insitucione shtetërore dhe private por në kurrikul të programit Inxhinieri Software nuk ka praktike profesionale të përfshirë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton së personeli akademik dhe ai administrative ka në dispozicion ambiente të dedikuara si dhe instrumenta të nevojshëm (kompjetera, internet, kancelari etj) për të kryer aktivite mësimore dhe administrative. Ambjentet e mësimdhënies janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike.</p> <p>Ambjentet janë të hapura dhe të aksesueshme nga i gjithë personeli akademik. Te gjitha auditoret ku zhvillohen leksione janë të pajisur me tabela, videoprojektorë, pc etj. Labororet janë të mire pajisur me të gjithë mjetet teknologjike të nevojshme.</p> <p>Në dispozicion te Fakultetit të Arkitektures dhe Inxhinierisë janë:</p> <p>7 auditore</p> <p>1 sallë konferencash</p> <p>9 klasa për seminare</p> <p>9 laboratorë</p> <p>[Evidenca Summary Tables BA_SWE_Annex 39.pdf]</p> <p>[Evidenca Vizita ne ambjente]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton së për të ndihmuar procesin mësimor lëndor është siguruar që të gjithë ambjentet mësimore të jenë të pajisura me tabela, projektor, pc, duke mundësuar një mësimdhënie jo vetëm teorike por edhe praktike. Universiteti është i angazhuar për ti ofruar studenteve teknologjitë më të fundit për të përmirësuar përvojën e tyre të mësim-nxënies. Gjthashtu nga vizita e GVJ me studentet ato u shprehen shumë pozitiv lidhur me përdorimin e teknologjive gjatë orëve mesimore.</p> <p>[Evidenca Summary Tables BA_SWE_Annex 39.pdf]</p>

të mësimdhënies-mësimnxënies.	[Evidenca Annex 28-Information on Infrastructure capacities.pdf] [Evidenca Vizita ne institucion]			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton së laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të inxhinierisë duke siguruar një mësimdhënie të orientuar nga praktika. [Evidenca Annex 28-Information on Infrastructure capacities.pdf] [Evidenca Vizita ne institucion]			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton së në dispozicion të Fakultetit janë 4 laboratorë kompjuterash, 1 laborator elektronik dhe 1 qëndër kërkimi dhe inovacioni. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me software të nevojshëm në mënyrë që të plotësoj nevojat e studentëve. Nga takimi me studentët ata u shprehën shumë të kënaqur përse i përket mundësive për të studiuar/punuar në laboratore të tillë. [Evidenca Annex 28-Information on Infrastructure capacities.pdf] [Evidenca Vizita në institucion]			
Konkluzione	<i>Universiteti Epoka ka mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve jane auditorë dhe laboratorë modern.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se cdo pedagog i vendos studentëve në dispozicion planprogramin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronike ose të printuar, mund të përdoren nga studentët për të përmirësuar dhe thelluar njohuritë në lëndet e programit që ato ndjekin.</p> <p>Materialet në formë elektronike gjëndën në klasat virtuale të krijuar në platformën google classroom. Gjithashtu universiteti Epoka disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët dhe stafi akademik janë anëtar dhe kanë akses në shërbimet e saj.</p> <p>[Evidenca Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 34.3-Information on Library Services.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 34.4-Directive on the library.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se cdo fillim viti akademik kordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me pedagogët e lëndës përditësojnë plan-programet e lëndeve.</p> <p>GVJ sygjeron që Literaturat e detyruara dhe rekomanduara në plan program-et e lëndëve të jenë të 5 viteve të fundit.</p> <p>[Evidenca Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve është biblioteka e Universitetit Epoka e cila ofron dhe shërbime online për stafin dhe studentet. Literaturat në bibliotekë shtohen cdo vit bazuar në kërksat e stafit akademik dhe komentet e studenteve.</p> <p>[Evidenca Annex 34.3-Information on Library Services.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 34.4-Directive on the library.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse,</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve është biblioteka e Universitetit Epoka. Në të ndodhen 2 milion libra të</p>



<p>e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>organizuara sipas fushës së ekspertizës. Universiteti është abonuar në bazën e të dhënave JSTOR për ti siguruar të interesuarëve një gamë të gjërë revistash shkencore. Gjithashtu në dispozicion të stafit dhe studentëve janë dhe burime të tjera elektronike si:</p> <p>Cambridge Journals Online, IOP Science OECD-I Library etj,</p> <p>[Evidenca Annex 34.3-Information on Library Services.pdf] [Evidenca Annex 34.4-Directive on the library.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në dispozicion të studenteve janë burimet elektronike si:</p> <p>Cambridge Journals Online, IOP Science, OECD-I Library etj,</p> <p>[Evidenca Annex 34.3-Information on Library Services.pdf] [Evidenca Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf]</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në bibliotekë ka pc në të cilët janë instaluar software-t e nevojshëm për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve që biblioteka ka apo ofron.</p> <p>[Evidenca Vizita në Bibliotekë] [Evidenca Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf]</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre,</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se orari i punës së bibliotekës është i rregulluar sipas orarit zyrtarë të punës së Universitetit Epoka.</p>



në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.									
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se nuk ka informacion lidhur me ndjekjen dhe raportimin e cilësisë së fondit fizik dhe elektronik të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka numëron rreth 2 milion libra, koleksioni i së cilës pasurohet nga:</p> <p>Blerjet e materialeve, Kërkesat e përdoruesve, Donacionet,</p> <p>[Evidenca Vizita në Bibliotekë]</p>								
Konkluzione	<i>Programi i lëndëve përmban literaturën e detyruar dhe rekomanduar. Në dispozicion të studentëve është biblioteka e universitetit e cila ka një hapësirë prej 400m², 100 poste studimi, 2 m libra fizik dhe platformë akses elektronik në shërbim të stafit dhe studentëve.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se Universiteti Epoka disponon një sitem Interaktiv EIS. Çdo student i regjistruar në Epoka u caktohet një llogari email nën domainin epoka.edu.al.</p> <p>Në EIS studenti mund të monitorojë studimet e tij në universitet si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hyrjen • Transferimin • Faturimet • Pagesat • Menaxhimin e Mesimdhënies • Klasat • Transkriptet e notave <p>Gjatë vizitës së kryer në zyrën e regjistrimit u shikuan regjistri themetar, rregjitrri i notave dhe disa procesverbale notash. Regjistri ishte i plotësuar në rregull. Nuk u gjendën parregullsi në hedhjen e rezultateve të studentëve nga procesverbalet në regjistrin themeltar.</p> <p>Dosjet e studentëve ishin të plota.</p> <p>Dosjet e trasferimeve ishin të plota.</p> <p>Dosjet e çregjistrimeve ishin të plota.</p> <p>[Evidenca Vizita në zyrën e regjistrimit/pranimeve] [Evidenca Annex 36-EIS Guideline lecturer-student.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se sistemi EIS siguron një dixhitalizim të proceseve të njëjësive të ndyshme. Brënda EIS secila njësi ka profin e saj , duke lejuar rrjedha të thjeshta të punës dixhitale dhe efikasitet të përmirësuar në menaxhimin e detyrave dhe aktiviteteve.</p> <p>[Evidenca Vizita në Zyrën e IT, pranimeve-regjistrimeve] [Evidenca Annex 36-EIS Guideline lecturer-student.pdf] [Evidenca Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente</p>	

për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se Universiteti Epoka disponon një sistem menaxhimi EIS i cili siguron një komunikim efikas ndërmjet studentit, pedagogut dhe të gjithë zyrave në funksion mbështetës të procesit mësimor.</p> <p>Komunikimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve mund të kryhet nëpërmjet adresave të tyre elektronike, kasave virtuale të ngritura në platformën google classroom.</p> <p>[Evidena Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf]</p>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se sistemi interaktiv Epoka EIS përveç studentëve, pedagogëve, këshiltarëve përdoret edhe nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Koordinatorët ✓ Zyra e Pranimeve ✓ Zyra e Regjistrimeve ✓ Zyra e Financës ✓ Zyra e Burimeve Njerëzore <p>Kështu sigurohet ndërveprim dhe bashkëpunim ndërmjet departamenteve për të menaxhuar në mënyrë efikase informacionin e nevojshëm për të përmbushur rolet dhe përgjegjësitë brenda universitetit.</p> <p>[Evidena Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf]</p>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka një faqe zyrtare web në të cilën gjenden informacione për universitetin, programet e studimit, kurrikulat e cdo programi studimi, personelin akademik dhe joakademik, kërkimin shkencor etj.</p> <p>[Evidenca https://www.epoka.edu.al/kreu.html]</p>
Konkluzione	<i>Universiteti Epoka ku bën pjesë programi i studimit Inxhinieri Software disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit</i>

	<i>institucional EIS dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit ekonomik, financiar dhe administrativ të programit të sistemit. Informacioni lidhur me universitetin, programet e studimit, kurrikulat e cdo programi studimi, personelin akademik dhe joakademik, kërkimin shkencor etj, gjenden në faqen zyrtare web të Epokës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në periudhën nga janari-mars të cdo viti akademik, rektorati depoziton formularë pranë fakulteteve të njësive bazë dhe njësive administrative të tjera të universitetit për të mbledhur informacion mbi nevojat e tyre specifike. Pasi formularët plotësohen ato i kthehen rektoratit e më pas prej rektoratit merren vendime bazuar në planin strategjik të Universitetit Epoka dhe Planet Strategjike të Njesisë. Propozimet miratohen nga Bordi i Administrimit. Universiteti Epoka siguron një planifikim efektiv financiar dhe shpërndarje të burimeve për të mbështetur objektivat e tij strategjike dhe nevojat specifike të njësive dhe fakulteteve të tij.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se universiteti Epoka i merr fondet parësore nga tarifat e studenteve, fondet e tjera përfshijnë projektet kërkimore ndërkombëtare dhe fonde të tjera kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare.

<p>të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se zyra e financës harton dhe i paraqet bordit të administrimit raporte që kanë të bëjnë me buxhetin e flukseve monetare. Cdo vit raporti i pasqyrave financiare i nënshtrohet kontrollit sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilizimit. Institucioni kryen auditime të përvitshme, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm kryhet nga auditës të brendshëm ose të jashtëm, të cilët zgjidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>[Evidenca Annex I-Statute of EPOKA University.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në fund të cdo viti akademik zyra e financës në bashkëpunim me zyrën e administratorit përgatit buxhetin përfundimtar të vitit akademik për cdo program studimi.</p> <p>[Evidenca Vizita ne IAL]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se bazuar në raportet financiare si: Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Performacës dhe pasqyrat e tjera financiare si dhe buxheti vjetor institucional, kompania dhe institucioni kanë bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar që garanton progres dhe qëndrueshmëri financiare të institucionit.</p>

të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	[Evidenca Tabela Përmbledhëse RVB BA SWE shqip.pdf Tabela 18]			
Konkluzione	<i>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ku bën pjesë programi i studimit Inxhinieri Software ka të drejtën e tij ligjore për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të realizimit të programeve të studimit që ofrohen. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i përballon shpenzimet e parashikuara për pagat, investimet, mallrat dhe shërbimet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në programet bachelor dhe master pranohen studentët vendas dhe të huaj sipas kuotave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit dhe miratimit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të ndjekin studimet në një nga programet e studimit që universiteti Epoka ofron, ata duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe ndjekin politikën dhe procedurat e regjistrimit. GVJ konstaton se këto politika dhe procedura janë të shprehura

	<p>në planin strategjik të universitetit, statutin e universitetin dhe rregulloren e tij.</p> <p>[Evidenca Annex 17-Admission criteria for undergraduate and graduate programs for 2022-2023 av.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 1.1-Basic Regulation.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se programi i studimit Inxhinieri Software mund të ndiqet nga cdo shtetas shiptare, shqiptarë etik jashtë kufijve shtetërore si dhe cdo shtetas i huaj, në bazë të kriterëve të përcaktuara. Universiteti Epoka krijon mundësi komunikimi me ambientin e jashtëm nëpërmjet web-it zyrtar, ditëve të informimit, etj.</p> <p>[Evidenca Annex 17-Admission criteria for undergraduate and graduate programs for 2022-2023 av.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se cdo vit akademik referuar urdhërit të Ministrisë se Arsimit dhe Sportit për regjistrimet dhe transferimet publikon në web-in dhe rrjetet sociale të universitetit informacion lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kriteret e Pranimit • Procedurat e Regjistrimit • Dokumentacionin e regjistrimit <p>[Evidenca https://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html]</p> <p>[Evidenca https://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-procedure-1923-1925.html]</p> <p>[Evidenca https://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-documents-1923-1938.html]</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se universiteti Epoka përgatit fletë-palosje informuese për të gjithë kandidatët e interesuar për të vijuar studimet e tyre në programin Inxhinieri Software. Informacioni është i publikuar në webin e universitetit. Rregullorja e</p>

<p>studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>përgjithshme e universitetit përshkruan në mënyrë të qartë procedurat për organizimin dhe ndërprerjen e studimeve, përparimin e studenteve gjatë kursit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit.</p> <p>[Evidenca Annex I.1-Basic Regulation.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se zyra e pranimit organizon një program të planifikuar të karrierës për maturantët. Në këtë program maturantët informohen në detaje mbi universitetin, kriteret e pranimit dhe kërkesat e nevojshme për tu regjistruar në universitetin Epoka.</p> <p>[Evidenca https://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html]</p> <p>[Evidenca https://eis.epoka.edu.al/curricula]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton që Universiteti Epoka nuk ka kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të kufizuara, ata të gjithë i kalojnë kriteret përkatëse të publikura nga zyra e Pranimit.</p> <p>Gjithashtu GVJ vlereson faktin që universiteti Epoka është ortak në projektin IDEA të financuar nga programi Erasmus + i cili ka për qëllim përmirësimin e aksesit, krijimin e kushteve të mësimdhënies të arsimit gjithëpërfshirës dhe zhvillimin e mundësive të punësimit SWD dhe studentët me vështirësi në të nxënë.</p> <p>[Evidenca Annex 17-Admission criteria for undergraduate and graduate programs for 2022-2023 av.pdf]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se universiteti Epoka publikon në faqen web të universitetit kriteret e pranimit në gjuhën shqipe dhe anglisht, duke ftuar për të aplikuar në programet që ajo ofron kandidatët vendas dhe të huaj që plotësojnë kriteret e pranimit dhe ndjekin procedurat e regjistrimit. Universiteti Epoka pranon një numër të kufizuar studentësh të huaj sipas kuotave të përcaktuara nga ministria. [Evidenca www.epoka.edu.al]</p>

<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se univeriteti Epoka ofron bursa për studentët me arritje të larta dhe gjithashtu jep bursa sociale për një grup studentësh në nevojë.</p> <p>[Evidenca Annex 44-On Scholarship.pdf]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti Epoka harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i></p> <p><i>Universiteti përdor faqen zyrtare të webit , rrjetet sociale si mjet komunikimi gjithëpërfshirës.</i></p> <p><i>Universiteti Epoka ofron mundësinë e regjitrimit në programin Inxhinieri Software të studentëve shqiptarë, të huaj etj.</i></p> <p><i>Universiteti ofron bursa për studentët me arritje të larta dhe bursa sociale.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët mund të marrin informacion lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studimeve, kalimin nga një vit akademik në tjetrin etj.</p> <p>Nota e sukseshme është CC.</p> <p>Nota e pasukseshme është FD dhe FF.</p>
	<p>Një student me notë mesatare kumulative prej 2.00 e lartë dhe pa notë FC ose FF në një lëndë në program cilësohet si i sukseshëm. Studenti duhet të kaloj të gjitha lëndët e programit</p>



	<p>për të përfunduar në mënyrë të kënaqshme programin e studimit universitar.</p> <p>[Evidenca Annex 1.1-Basic Regulation.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 13-Regulation on undergraduate study program.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve vihet informacion lidhur me njohjet dhe transferimet e krediteve të studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë Universitetit Epoka si dhe universiteteve të tjera. Ky informacion publikohet në sistemin EIS dhe faqen Web të universitetit.</p> <p>[Evidenca Annex 17.2-Directive on Student Transfer.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët njihen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me të gjithë elementët që kanë të bëjnë me vlerësimin e tyre. Këto informacione gjenden në rregulloren e përgjithshme të universitetit, rregulloren e studentëve, gjithashtu në cdo fillim semestri pedagogu informon studentin lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Rezultatet e provimeve të studentëve mund të aksesohen në llogaritë e tyre personale në sistemin EIS.</p> <p>[Evidenca Annex 1.1-Basic Regulation.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 30-Smart Student Guide.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 2.1-Curriculum change proposal. syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët njihen me kriterët dhe procedurat e diplomimit nëpërmjet rregullores së përgjithshme të universitetit. Një student i cili ka qënë i suksesshëm në të gjithë lëndet e programit të studimit, ka arritur mesataren e notës së tij/saj në të paktën (2.00), pa pasur note FD ose FF do të konsiderohet se ka plotësuar kërkesat e diplomimit me vendimin përkatës të bordit dhe do ti jepet diploma universitare.</p>


	[Evidenca Annex I.1-Basic Regulation.pdf]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se zyra e pranimeve organizon programin e planifikimit të karrierës për maturantët. Informacion lidhur me kuotat, kriteret e pranimit etj janë të publikura në portalin U-Albania. Zyra e karrierës së studentëve nga ana e saj luan një rol të vecantë lidhur me orientimin dhe informimin e të interesuarve për të vijuar studimet në Inxhinieri Software.			
Konkluzione	<p><i>Universiteti Epoka jep informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program nëpërmjet rregullores së përgjithshme të universitetit.</i></p> <p><i>Nëpërmjet webit të universitetit, rrjeteve sociale EIS etj, jepet informacion për të interesuarit lidhur me pranimet dhe regjistrimet në programin e studimit Inxhinieri Software.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në Statutin e Universitetit parashikohet në mënyrë të detajuar struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e studimeve.</p> <p>Informacion ky që paqyrohet në webin e universitetin, sistemi EIS. Cdo vit të ri akademik, organizohet java e orientimit dhe informimit ku drejtuesi i njësisë bazë së bashku me stafin akademik organizojnë takime informuese me studentët e vitit të parë, lidhur me vijueshmërinë e studimeve të tyre.</p>

	[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët njihen me kurrikulën e programit të tyre të studimit, ku mund të gjejnë informacion më të detajuar për lëndët e ofruara.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se të gjithë studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga zyra e planifikimit të karrierës dhe alumni. Nga takimi me zyrën e karrierës, me studentët e programit Inxhinieri Software, GVJ vlerëson faktin që universiteti Epoka ka një gamë të gjerë marrëveshesh bashkëpunimi, duke ofruar kështu gamë të gjerë mundësih punësimit. Nga zyra e planifikimit të karrierës dhe Alumin organizohen aktivitetet të shumta gjatë gjithë vitit. Aktiviteti më i rëndësishëm është organizimi i përvitshëm i panairit të karrierës, në të cilin marrin pjesë kompani të shumta duke u ofruar studentëve dhe të diplomuarve mundësi intervistash për vende të lira pune dhe programe praktike.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se gjatë javës së parë orientuese, studentët e vitit të parë marrin informacion të detajuar në lidhje me programin e tyre të studimit, duke përfshirë zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e disponueshme. Gjithashtu të gjithë studentët e regjistruar marrin një udhëzues Smart Student që përmban informacion thelbësor në lidhje me programin e studimit. Gjatë javës së parë pedagogët u ofrojnë studentëve informacion lidhur me planprogramet e lëndeve. [Evidenca Annex 2.1-Curriculum change proposal, syllabuses, tables 9,10,11,12,13,15.pdf] [Evidenca Annex 30-Smart Student Guide.pdf]
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ

<p>menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>konstaton se nëpërmjet EIS i cili mund të aksesohet nëpërmjet internetit kudo që ndodhen studentët.</p> <p>GVJ vlerëson faktin që nëpërmjet tij të gjithë përdoruesit kanë informacion në të dhënat personale dhe mund të përditësojnë detaje të përgjithshme. Studentët në profilin e tyre mund të aksesojnë informacionin e tyre personal dhe informacionin lidhur me programin e studimit. Gjithashtu adresat zyrtare të emailit janë një mjet mjaft efikas për komunikim.</p> <p>[Evidenca Annex 36-EIS Guideline lecturer-student.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 37-Information and Communication Technology Services.pdf]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti Epoka u jep informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, nëpërmjet statusit dhe rregullores së universitetit. Nëpërmjet panairit të karrierës studentëve u ofrohen mundësi punësimi.</i></p> <p><i>Sistemi interaktiv EIS është një sistem menaxhimi online që u ofron studentëve aksesimin nga ku ato ndodhen të informacionit personal dhe të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në universitetin Epoka, zyra e regjistrimit mban të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në çdo programi studimi. Në programin e studimit Inxhinieri Software janë regjistruar :</p> <p>v.a. 2020 – 2021 – 51 studentë; v.a. 2021 – 2022 – 101 studentë; v.a. 2022 – 2023 – 138 studentë;</p> <p>Brezi i parë i studentevë është diplomuar në vitin 2022-2023, në këtë vit akademik nuk kanë evidencë për të diplomuarit.</p> <p>[Evidenca Summary Tables_BA_SWE_Annex 39.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në universitetin Epoka zyra e regjistrimit mban të dhëna për numrin e studentëve të rregjistruar dhe diplomuar në programin e studimit Inxhinieri Software, ose numrin e studentëve të çregjistruar. Referuar statistikave të vëna në dispozicion në programin e studimit Inxhinieri Software janë çregjitruar student dhe këto statistika janë të ruajtura në zyrën e regjistrimit dhe pranimeve.</p> <p>[Evidenca Summary Tables_BA_SWE_Annex 39.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se të dhënat statistikore të studentëve janë të sigurta fizikisht në kampus dhe aksesohen vetëm nga persona të autorizuar të stafit. Administratorët e serverave dhe bazës së të dhënave kanë një marrëveshje konfidencialiteti me universitetin Epoka.</p> <p>[Evidenca Annex 36-EIS Guideline lecturer-student.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se zbatimi i të gjithë proceseve dhe procedurave sigurohet nga grupi i auditimit të brendshëm. Gjatë auditimit, grupi i auditimit të brendshëm i referohet kriterëve që rrjedhin nga politika e cilësisë, aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare</p>



<p>mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>për arsimin e lartë, statute dhe rregulloret e universitetit Epoka, procedurat e punës së njësive dhe auditimi i gjetjeve të mëparshme.</p> <p>[Evidenca Annex 45-Internal Audit 2019-Non Compliance Reports.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 46-Decision of the Rectorate of epoka university.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 47-Quality Policy.pdf]</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në universitetin Epoka zyra e regjistrimit harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit është njësia përgjegjëse e cila mban një bazë të dhënash lidhur me të dhënat e plota të studentëve të diplomuar. Nga takimi me përfaqësues të zyrës, ata u shprehën se për ta është relativisht e vështirë për të ndjekur dhe patur informacione lidhur me punësimin e studentëve pasi ata janë diplomuar.</p> <p>GVJ vlerësoj faktin që universiteti Epoka zhvillon cdo vit takimin e Alumnit, ku takohen studentët e diplomuar dhe universiteti e shfrytëzon këtë moment për të marr informacione më shumë nga studentët e diplomuar.</p> <p>Megjithatë, programi Inxhinieri Softueari ka diplomuar vetem një brez studentësh dhe deri tani aktualisht për këta Alumni nuk ka statistika konkrete.</p> <p>[Evidenca Summary Tables BA_SWE Annex 39.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 4-Alumni Survey 2019-2020.pdf]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në universitetin Epoka të dhënat statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, çregjistruar dhe diplomuar mbahen nga zyra e regjistrimit, të dhënat lidhur me shkallën e punësimit të studentëve pasi kanë mbaruar studimet mbahen nga zyra e planifikimit të karrierës dhe Alumni.</i></p> <p><i>I gjithë procesi i zbatimit të gjithë proceseve dhe procedurave sigurohet nga grupi i auditimit të brendshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në universitetin Epoka është ngritur Organi i Këshillit Studentor. Objektivi i Këshillit Studentor të Universitetit Epoka është të sigurojë zhvillim akademik të studentëve ashtu dhe rritjen e tyre sociale e personale.</p> <p>Këshilli Studentor përbëhet nga përfaqësues të studentëve të zgjedhur në mënyrë demokratike për të përcjellë peticionet e studentëve në Administratën e Universitetit dhe për të kontribuar në aktivitetet arsimore të Universitetit. Në këshillin studentor ka dhe përfaqësues të studentëve nga programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Software”.</p> <p>Më poshtë antarë të këshillit studentorë të cilët ndjekin programin “Inxhinieri Software”:</p> <p>2020-2021-Klea Xhina 2021-2022-Klea Xhina 2021-2022-Anita Mjeshtri 2022-2023- Tea Meraj 2022-2023- Anita Mjeshtri 2022-2023 - Klea Xhina (2020-2021 faqe 11, 2021-2022 faqe 7, 2022-2023 faqe 91) [Evidenca Annex 20.1-Statute of Student Council.pdf] [Evidenca https://dos.epoka.edu.al/cat-student-council-669.html] [Evidenca https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-for-mas-1479-2743.html (2020-2021 faqe 11, 2021-2022 faqe 7, 2022-2023 faqe 91)]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse të Universitetit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik • Komisioni i përhershëm për sigurimin e Cilësisë.

<p>jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>[Evidenca Annex 20.1-Statute of Student Council.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët përfshihen në mënyrë indirekte në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Kjo kryhet nëpërmjet anketave që zhvillohen për vlerësimin e instruktorit të lëndës, sondazhit të Alumnit. Gjithashtu studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse të Univerisitetit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik • Komisioni i përhershëm për sigurimin e Cilësisë. <p>[Evidenca Annex 20.1-Statute of Student Council.pdf] [Evidenca Annex 4-Alumni Survey 2019-2020.pdf] [Evidenca Annex 12.3- Course Instructor Evaluation Survey.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët kanë përfaqësues të tyre në organin më të lartë të vendimarrjes akademike të universitetit, Senati Akademik. Anëtarët e këshillit studentor që përfaqësojnë komunitetin studentor kanë të njëjtën të drejtë vote dhe të shprehin shqetësimet si të gjithë anëtarët e tjerë të organeve të përmendura. GVJ gjatë vizitës vlerësoi faktin që ZSBC inkurajon studentët në plotësimin e formularëve të vlerësimit të instruktorëve duke siguruar një element të rëndësishëm që përdoret për përmirësimin e aktivitetit mësimor. Gjithashtu dhe departamenti ofron shërbime kërkimore për studentët.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në universitetin Epoka studenët janë të përfaqësuar nëpërmjet Këshillit Studentor. Kryetari dhe nënkryetari i të cilës janë anëtar të Senatit Akademik.</i></p> <p><i>Gjithashtu anëtar të Këshillit Studentor janë anëtar të komisionit të përhershëm për sigurimit të cilësisë.</i></p> <p><i>Nëpërmjet anketave për instruktoret e lëndëve dhe anketës Alumni studentët angazhohen në mënyrë indirekt mbi procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se për ofrimin e informacionit të plotë mbi përparimin akademik dhe mundësinë e zhvillimit të karrierës në universitetin Epoka janë zyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Regjistrimit • Zyra e Planifikimit dhe Alumni <p>Procedurat që ndiqen për informimin dhe shërbimet ndaj studentëve përcaktohen në statusin dhe rregulloren e universitetit Epoka.</p> <p>[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 1.1-Basic Regulation.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se çdo student pas regjistrimit pajiset me një adresë emaili me kredencialet e sistemit EIS nga ku marrin në cdo kohë të gjitha njoftimet lidhur me përparimin e studimeve.</p> <p>[Evidenca Annex 30-Smart Student Guide.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se këshillimi i karrierës sigurohet nga zyra e planifikimit të karrierës dhe Alumni. ZPKA ofron një gamë të gjërë shërbimesh për të ndihmuar studentët të eksplorojnë dhe identifikojnë tiparet dhe interesin e tyre personal, të mësojnë</p>

periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	rreth opsioneve të karrierës, të fitojnë përvoja praktike dhe të përgatiten për karrierën e tyre të ardhshme.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se zyra e planifikimit të karrierës dhe alumni mbledh dhe ruan informacion lidhur me të dhënat dhe rezultatet e punësimit të të diplomuarve, duke përfshirë llojet e punës dhe cilësinë e punësimit. GVJ-së nuk ju janë vënë në dispozicion të dhëna të sakta statistikore lidhur me rezultatet e punësimit të studentëve të diplomuar në Inxhinieri Software.			
Konkluzione	<i>Universiteti Epoka ka procedura që përcaktojnë lidhjen me informimin dhe shërbimet ndaj studentëve të përcaktuar në statut dhe rregulloren e tij. Këshillimi i karrierës sigurohet nga zyra e planifikimit të karrierës dhe alumni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se ka hartur dokumentin “Strategjia Kuadër e Universitetit Epoka në të cilin përshkruan si prioritet të parë institucional “Ofrimin e një mjedisi me cilësi të lartë për mësimdhënie dhe mësimnxënie”.Universiteti Epoka për të përmirësuar metodat e mësimdhënies është përfshirë dhe në projektin Erasmus+ “Shkëmbimi virtual Shqiptar i Universiteteve” ku objektivi i këtij projekti ishte kualifikimi i stafit akademik në IAL shqiptare mbi metodologjitë modern pedagogjike dhe didaktike për mjedise mësimore novatore.</p> <p>[Evidenca Annex 5-EPOKA University Strategy.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka mekanizma të cilët bëjnë monitorim dhe vlerësimin në mënyrë periodike aftësitë e personelit akademik. Konkretisht, zbatohen masat më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sontazhi i Vlerësimit të Instruktorëve të Lëndës • Vizitat në klasë si masë e rishikimit të brëndëshëm <p>[Evidenca Annex 11-Policy on Continuous improvement.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 16-Quality Assurance Handbook.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët përshihen në vlerësimin periodik të instruktorëve të lëndës dhe dërgimin tek dekani i zyrës së studentëve, ankimime lidhur me mësimdhënien, profesorët, çështjet financiare etj, sipas formularit të kërkesës së Studentëve.</p> <p>[Evidenca Annex 12.3- Course Instructor Evaluation Survey.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 15.2-Student Request Form.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se rezultatet e sondazheve të kryera për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të personelit akademik publikohen në webin e universitetit.</p>

	[Evidenca https://epoka.edu.al/home-staff-annual-reports-6-48.html]			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se institucioni ka miratur “Matjen e performancës Akademike” dhe “Formularin e Vlerësimeve” që vlerëson performacën e mësimdhënies në shkallë 1-5. [Evidenca Annex 12-Directive on Academic and Administrative performance assesment and quality imporvment.pdf]			
Konkluzione	<i>Universiteti Epoka ka mekanizma të cilët bëjnë monitorim dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive të personelit akademik, në këto mekanizma janë të përfshirë dhe studentët, rezultatet e monitorimit dhe vlerësimin bëhen publike në faqen web të universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se nga Senati Akademik i Universitetit është krijuar Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë përbëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e sigurimit të cilësisë • Komisioni i zhvillimit të kurrikulave • Bordi i provimeve • Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë.
	Secila nga këto njësi ka funksione të mirë përcaktuara në rregulloren e Universitet. Të gjitha dokumentat e sigurimit të cilësisë janë të disponueshme për publikun në web-in e universitetit.

	<p>[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 12-Directive on Academic and Administrative performance assesment and quality imporvment.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 16.1-Regulation on the Organization and Functioning of pqqa.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 47-Quality Policy.pdf]</p> <p>[Evidenca https://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se studentët, ish studentët dhe ekspertë të jashtëm janë anëtarë të KPSCsë. GVJ konstaton se në këto njësi nuk ka studentë që studiojnë në programin e studimit Inxhinieri Software. Megjithatë, Studentët dhe anëtarët e programit të studimit Inxhinieri Software janë të përfshirë në përgatitjen e Raporteve të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit insitucional dhe programeve të studimit.</p> <p>[Evidenca Summary Tables BA SWE Annex 39.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se institucioni dhe të gjithë programet e studimit të ofruara prej tij i janë nënshkruar procesit të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike dhe krahasuese, si dhe proceseve të tjera që nxisin dhe përmirësojnë cilësinë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes,</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar tregues të qartë dhe të matshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për të vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta sipas direktivës për</p>

<p>arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>vlerësimin e performancës. Gjithashtu secili anëtar i stafit akademik përvec mësimdhënies është i angazhuar dhe në kërkime akademike sipas fushës së kërkimit.</p> <p>[Evidenca Annex 12-Directive on Academic and Administrative performance assesment and quality imporvment.pdf]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në universitetin Epoka është ngritur Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Të gjitha dokumentat e sigurimit të cilësisë janë të disponueshme për publikun në web-in e universitetit. Studentët dhe anëtarët e programit të studimit Inxhinieri Softuere janë të përfshirë në përgatitjen e Raporteve të vlerësimit të brëndshëm në kuadër të akreditimit insitucional dhe programeve të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se përgjegjës për monitorimin e programit të studimit është departamenti ku programi bën pjesë. Politika e Përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit përdoret nga departamenti në rastet kur monitorohet dhe rishikohet programi. Gjithashtu universiteti Epoka ofron analiza vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve te studimit, të cilat përshijnë të dhëna për aspektet akademike dhe të dhënat për performancën e studentëve për cdo program studimi, si niveli i kalueshmërisë, shkalla e diplomimit, niveli i punësimit etj.</p> <p>[Evidenca Annex 11-Policy on Continuous improvment.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 27-Raporti Vjetor 2021-2022.pdf]</p>

<p>dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit të udhëzimeve të lëndës përfshijnë rezultatet e pritura dhe rezultatet e vlerësimit. Universiteti përgatit një plan veprimi për të adresuar çështjet dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u dërgohen Departamenteve përgjegjëse për programin e studimit, dekanateve, komisionit të përhershëm të sigurimit të cilësisë, rektoratit dhe senatit akademik.</p> <p>[Evidenca Annex 12.3- Course Instructor Evaluation Survey.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se institucioni përdor metodën e vlerësimit të drejtpërdrejt. Metodatat direkte përfshihen në planprogramet e lëndëve.</p> <p>{Evidenca Annex 2.1-Curriculum change proposal syllabuses. tables 9,10,11,12,13,15.pdf}</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në kuadër të vlerësimit të realizimit dhe</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>mbarvajtjes së cilësisë së programit të studimit, institucioni përdor metodat indirekte të vlerësimit si më poshtë:</p> <p>Sondazhi i vlerësimit të instruktorëve të lëndës të kryer nga studentët në fund të cdo semestri, ku studentët japin mendimet e tyre për metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies, performancë etike të pedagogut dhe përmbajtjen e lëndës.</p> <p>Sondazhi i Këshillit të Studentëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve kryhet cdo vit nga Dekani i zyrës studentore.</p> <p>Sondazhi i Alumni kryhet cdo vit akademik nga zyra e planifikimit të karrierës dhe Alumni për të mësuar mbi zbatueshmërinë dhe praktikitetin e njohurive të fituara gjatë studimeve.</p> <p>Sondazhi i Këshillit të kompanisë kryhet cdo vit nga zyra e planifikimit të karrierës dhe Alumni për të marrë komente të duhura mbi performancën e të diplomuarve në Epoka.</p> <p>GVJ konstaton se statistika konkrete për programin Inxhinieri Softueri të sondazheve më lartë nuk ka.</p> <p>[Evidenca Annex 12.3- Course Instructor Evaluation Survey.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 20.6-Student Satisfaction Survey.pdf]</p> <p>[Evidenca Annex 4-Alumni Survey 2019-2020.pdf]</p> <p>[Annex 4.1-Company Satisfaction Survey Reports.pdf]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti Epoka ka procedura, formulare për monitorimin dhe vlerësimin nëpërmjet pyetsorëve dhe sondazheve të kryera nga zyra e planifikimit të karrierës dhe alumnit në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ nuk i janë vënë në dispozicion rezultate konkrete të arritura nga monitorim .</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se duke ju referuar përbërjes së senatit akademik dhe komisionit të përhershëm të sigurimit të cilësisë është e qartë që institucioni siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se institucioni i përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat specifike të njësisë kryesore, individëve studentëve dhe palëve të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se gjatë përgatitjes së raporteve të vlerësimit të brendshëm janë përfshirë aktorë nga të gjitha palët e interesuara, raporti vjetor institucional përgatitet nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me njësinë kryesore, njësinë bazë dhe të gjithë anëtarët e stafit akademik. Tregues këto të përfshirjes së njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p> <p>[Evidenca Annex 1-Statute of EPOKA University.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se aktorët e brendshëm të përfshirë dhe të angazhuar</p>


<p>ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>në proceset e vlerësimit të vazhdueshëm nuk kanë qënë subjekt i asnjë lloj diskriminimi apo pabarazie. Te gjithë aktorët e brendshëm që janë pjesë e organeve të sigurimit të cilësisë kanë të njëjtën të drejtë vote dhe të shprehin shqetësimin si të gjithë anëtarët e tjerë.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se në komisionin e përhershëm të sigurimit të cilësisë përfshihen anëtarë/ekspertë të jashtëm dhe një përfaqësues alumini. Gjithashtu kompanitë që kanë punësuar të diplomuar në Epoka japin komentet e tyre për performancën e studentëve të diplomuar në punë.</p> <p>GVJ shprehet se nuk ka të dhëna konkrete sa më sipër.</p> <p>[Evidenca Annex 4.1-Company Satisfaction Survey Reports.pdf]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nëpërmjet Senatit Akademik dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të cilësisë është e qartë që institucioni siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të programit të studimit.</i></p> <p><i>Gjithashtu kompanitë që kanë punësuar të diplomuar në Epoka japin komentet e tyre për performancën e studentëve të diplomuar në punë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se politika, strategjia, organizimi dhe aktivitet në kuadër të progamit të studimit Sistemi i Sigurimit të</p>

<p>Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Brëndshëm të Cilësisë janë të disponueshme për të gjitha palët e interesuara në faqen e web-it të Epokës. Informacioni në lidhje me sistemin e sigurimit të brëndshëm të cilësisë është i përfshir në udhëzuesin e studentëve.</p> <p>[Evidenca www.epoka.edu.al]</p> <p>[Evidenca Annex 30-Smart Student Guide.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se universiteti Epoka publikon rezultatet e vlerësimit të programit të studimit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale në website-in zyrtarë të universitetit.</p> <p>[Evidenca www.epoka.edu.al]</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se cdo raport i vlerësimit shoqërohet me një plan masash në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve.</p> <p>[Evidenca Annex 11-Policy on Continous improvment.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se universiteti Epoka kryen rishikime të shpeshta të qasjes së tij ndaj procedurave të cilësisë në mënyrë që të sigurojë përshtatshmërine dhe vlerën e tyre të vazhdueshme. Efektiviteti i këtyre procedurave vlerësohet nëpërmjet mekanizmave: Raporte/komente nga rishikuesit e jashtëm.</p> <p>Mbyllja e ciklit të komenteve të studentëve përmes “sondazhit të studentëve”</p> <p>Treguesit kryesor të performancës.</p> <p>[Evidenca Annex 48-Annual Report on Quality Assurance Activities of the PCQA.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Epoka, GVJ konstaton se cdo vit nga fakulteti në bashkëpunim me njësinë e sigurimit të brëndshëm të cilësisë organizohen aktivitete me studentët dhe stafin në lidhje me përfundimin e studimit të vlerësimit të instruktorëve dhe procesit të vetëvlerësimit në</p>

sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	kuadër të akreditimit të progameve dhe institucioneve të studimit. Gjithashtu organizohen aktivitete trajnuese për stafin e përfshirë në strukturat e sigurimit të cilësisë. [Evidenca Annex 8.2-List of training activities organized at institutional level and delivered to all all the staff of the study program.pdf]			
Konkluzione	<i>Politika, strategjia, organizimi dhe aktivitetet në kuadër të programit të studimit Sistemi i Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë janë të disponueshme për të gjitha palët e interesuara në faqen e web-it të Epokës. Fakulteti në bashkpunim me njësinë e sigurimit të brëndshëm të cilësisë organizohen aktivitete me studentët dhe stafin në lidhje me përfundimit të studimit të vlerësimit të instruktorëve dhe procesit të vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit të progameve dhe institucioneve të studimit duke siguruar kështu krijim e kulturës së brëndshme të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Softueri" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti EPOKA

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni kujdeset në përditësimin e vazhduar të programit të studimit, në përputhje me nevojat e tregut të punës, kurrikulave analoge të vendeve anëtare të BE, dhe zhvillimet më të fundit të fushës.
2. Institucioni angazhon në mësimdhënie staf akademik të kualifikuar, me eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale.
3. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione vendase dhe të huaja, përmes të cilave mundëson shkëmbimin e stafit dhe studentëve, ndarjen e eksperiencave dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në përputhje me nevojat e programit të studimit.
4. Institucioni në funksion të këtij programi studimi disponon laboratorë me pajisje bashkë kohore për zhvillimin e aftësive të studentëve në përputhje me nevojat konkrete të tregut e punës.
5. Programi studimi i bazuar në gjuhën anglezë. Nga njëra anë ofron mundësinë e regjistrimit të studentëve të huaj nga ana tjetër krijon avantazh në qasjen në tregun ndërkombëtarë të punësimit për studentët e diplomuar.
6. Krijimi dhe angazhimi i studentëve në klubet studentore si: "Klubi i Programimit", "Klubi i Inovacionit", "Klubi Virtual/Tregu i Shtruar" dhe "Klubi Robotikës".
7. Lidhje e fortë dhe ndërvepruese student -pedagog.
8. Ofrimi i bursavë për kategori të caktuara studentësh.
9. Institucioni ka një sistem Epoka LMS të avacuar.
10. Përfshirja e studentëve në qeverisje dhe vendimmarrje.
11. Bibliotekë moderne dhe me një numër konsiderueshëm botimesh.
12. Angazhimi i stafit dhe studenteve në projekte ndërkombëtare.

Pika të dobta:

1. Institucioni nuk harton raporte analitike të mirëfillta të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar. **(Standarti I.2)**
2. Në kurrikul nuk përfshihet "Praktika Profesionale" në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018. **(Standarti II.1, Kriteri.4)**
3. Institucioni nuk siguron program të njëjtë studimi në ciklet pasuese (master shkencor dhe/ose master profesional) për studentet e diplomuar ne Inxhinieri Software.

Rekomandime:

1. Institucioni të hartojë raporte analitike të mirëfillta të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar.
2. Institucioni të marrë masa për të ulur ngarkesën mesimore të personelit akademik.
3. Institucioni të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit Inxhnieri Software, praktikën profesionale, në përputhje me përcaktimet e veprimtarisë së kategorisë D, sipas VKM 41, dt. 24.01.2018.
4. Të organizohen konferenca studentore që të angazhohen studentët me research dhe prezantime.
5. Institucioni të ofroj program studimi të ciklit të dytë me të njëjtin profil me atë të ciklit të parë (Inxhnieri Software).



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Software Engineering" provided by the Higher Education Institution EPOKA UNIVERSITY

Strengths and affirmations

1. The Institution takes care to continuously update the program of study, in accordance with the needs of the labor market, the similar curricula of EU member countries and the latest developments in the field.
2. The Institution engages in teaching qualified academic staff with long academic and professional experience.
3. The Institution has cooperation agreements with national and international institutions, through which it enables the exchange of staff and students, the sharing of experiences and the development of professional practices of students in accordance with the needs of the program of study.
4. The institution in function of this program of study has laboratories with modern equipment for the development of students' skills in accordance with the concrete needs of the labor market.
5. Study program based on the English language. On the one hand, it offers the possibility of registering foreign students, on the other hand, it creates an advantage in accessing the international employment market for graduate students.
6. Creation and engagement of students in student clubs such as: "Programming Club", "Innovation Club", "Virtual Club/Placed Market" and "Robotics Club".
7. Strong and interactive student-teacher relationship.
8. Providing scholarships for certain categories of students.
9. The institution has an advanced Epoka LMS system.
10. Involvement of students in governance and decision-making.
11. Modern library with a significant number of publications.
12. Engagement of staff and students in international projects.

Weaknesses


1. The institution does not prepare analytical reports on the benefits from cooperation agreements, clearly specifying the benefits for each program of study offered.
2. The Institution should add "Professional Practice" in the Curricula of the Programming Study.
3. The institution does not provide the same study program in subsequent cycles (scientific master and/or professional master) for students who graduated in Software Engineering.

Recommendation

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



1. The Institution should prepare analytical reports on the benefits from cooperation agreements, clearly specifying the benefits for each program of study offered.
2. The institution should take measures to reduce the teaching load of the academic staff.
3. The Institution should add “Professional Practice” in the Curricula of the Programming Study. Institucioni, in accordance with the legislation in force VKM 41, dt. 24.01.2018.
4. The Institution should organize “Students Confernces” in order to engage the studens in research and presentations.
5. The institution should offer a study program of the second cycle with the same profile as that of the first cycle (Software Engineering).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

